



© Tth / Grace Medina - Albania

Drejtësia restauruese në rastet që përfshijnë fëmijët viktima

në Shqipëri



i-RESTORE
Better Protecting Child Victims
Rights through Restorative Justice

Dhjetor 2020

**Përgatitur nga
Prof. dr. Mariana SEMINI-TUTULANI**



Terre des hommes
Ndihmë për fëmijët.

rjn  **restorativejustice.nl**

 **EUROPEAN
FORUM FOR
RESTORATIVE
JUSTICE**





i-RESTORE është bashkëfinancuar nga Program i Drejtësisë i Bashkimit European (2014-2020).

Disclaimer

Përmbajtja e këtij raporti përfaqëson pikëpamjet e autorit dhe është vetë përgjegjësi e tij/saj. Komisioni European nuk mban asnjë përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që ky raport përmban.

Tabela e përmbajtjes

Akronime	4
Mirënjohe	5
Përmbledhje e përgjithshme	6
1. Panorama e drejtësisë restauruese në Shqipëri	9
1.1 Zhvillimi i drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit: vështrim i përgjithshëm historik	9
2. Kuadri Ligjor	12
2.1 Ligje të posaçme me parashikime specifike për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese	12
2.2 Ligje të posaçme që ofrojnë mbrojtjen e fëmijëve me fokus tek të drejtat e fëmijës viktimë	14
2.3 Kuptimi i përgjithshëm i politikave të drejtësisë restauruese dhe avantazhet e ndërmjetësimit	17
2.4 Zbatimi i drejtësisë restauruese te fëmijët e përfshirë në drejtësinë për të miturit dhe fëmijët viktimë	17
2.5 Iniciativa të tjera që trajtojnë fëmijët viktimë	18
2.6 Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në sistemin arsimor: shkollat	20
2.7 Përmbledhje e trajnimeve mbi drejtësinë miqësore për fëmijët	20
3. Metodologji kërkimore	24
4. Gjetjet e kërkimit	26
4.1 Politikëbërësit	26
4.1.1 Objektivat e Politikës së Shtetit Shqiptar referuar dokumentacionit kryesor	26
4.1.2 Kuptimi i politikave të drejtësisë restauruese dhe masat për lehtësimin e procesit të drejtësisë për të miturit	28
4.1.3 Programe për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin	31
4.1.4 Programe dhe projekte të fokusuara tek drejtësia miqësore për fëmijët	33
4.2 Institucionet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit	34
4.2.1 Praktika kombëtare dhe jurisprudence në drejtësinë për të mitur/drejtësinë restauruese/ndërmjetësimin	34
4.3 Të dhënat e analizuara nga pyetësorët	38
4.4 Rezultatet e kërkimit me anëtarët e Bordit Këshillimor të Fëmijëve dhe fëmijët viktimë	41
4.5 Rezultatet e kërkimit për fëmijët viktimë	43
Konkluzione dhe Rekomandime	46
Bibliografi	50
Annex 1	53
Lista e të intervistuarve	53

Akronime

FSHZK

Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konflikteve

ASCAP

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

BKF

Bordi Këshillimor i Fëmijëve

KDPM

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KDM

Kodi i Drejtësisë për të Mitur

DR

Drejtësia Restauruese

CoE

Këshilli i Europës

NJMF

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

VKM

Vendim i Këshillit të Ministrave

DHF

Dhuna në familje

DPB

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

PP

Prokuroria e Përgjithshme

KLJG

Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLP

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

IMK

Instituti për të Mitur, Kavajë

GTN

Grupi Teknik Ndërsektorial

MD

Ministria e Drejtësisë

MSHMS

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MA

Ministria e Arsimit

SHM

Shkolla e Magjistraturës

ALDF

Agjencia Lokale për të Drejtat e Fëmijëve

AKSHI

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

DHKA

Dhoma Kombëtare e Avokatisë

DHKN

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve

OJQ

Organizatë joqeveritare

PMF

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës

SHP

Shërbimi i Provës

ASHDMF

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

ASBZH

Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit

Tdh

Terre des hommes

SHLFT

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

UN KDF

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

ZKLBKBR

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

UNICEF

Fondi Emergjent Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

NVA

Ndërmjetësimi viktimë-I akuzuar

WV

World Vision

Mirënjohje

Ky raport u përgatit nga Prof. Dr. Mariana SEMINI në kuadër të projektit "I-restore", i financuar nga Bashkimi Europian dhe i koordinuar nga Terre des Hommes.

Falenderime të veçanta shkojnë për ekipin e Terre des hommes: Z. Marcos De Barros, Znj. Annemieke Wolthuis, Znj Emanuela Biffi dhe Znj. Naureda Bajraktari për përgatitjen paraprake të dokumentacionit të kërkuar dhe ofrimin e kontributit për këtë kërkim. Falenderime shkojnë po ashtu për Znj. Amanda Taylor për punën e saj në redaktimin e raportit.

Gjithashtu, falenderime të veçanta shkojnë për perfaqësuesit e lartë të Ministrive, Gjykatave, Prokurorive dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ashtu sikurse dhe të gjithë profesionistëve që lehtësuan procesin e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave, përkatësisht: Znj. Fjoralba Caka, Z. Artan Shkëmbi, Prof Arta Mandro, Z. Ervin Karanxha, Z. Rasim Gjoka, Znj. Brunilda Dervishaj, Znj. Ilsa Dede, Znj. Arda Lazareni, Znj. Drita Avdyli, Znj. Merita Xhediku, Znj. Rezarta Abdiu, Znj. Loreta Mamani, Znj. Blerta Hysenaj, Znj. Nertila Sylenji dhe të gjithë profesionistët e tjerë.

Përmbledhje e përgjithshme

Ky kërkim është pjesë e projektit "I-RESTORE- Të mbrojmë fëmijët viktime përmes drejtësisë restauruese" dhe synon të identifikojë mangësitë dhe sinergjitë që lidhen me zbatimin e drejtësisë restauruese (DR) në rastet kur përfshihen fëmijët viktime. Ndër objektiva të tjerë, projekti ka identifikuar praktikën e drejtësisë restauruese në Shqipëri, me një fokus në veçantinë e këtij procesi dhe ekzistencën e praktikave më të mira kur punojmë me fëmijët.

Pjesa e parë e këtij raporti adreson historinë e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese (DR) në Shqipëri. Historikisht, shoqëria shqiptare ka qenë e familjarizuar me zakonet e pajtimit dhe ndërmjetësimit në rastet e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve midis njerëzve. Më tej, me rënien e regjimit komunist, ndërmjetësimi nisi të zbatohet sërish. Ndërmjetësimi në çështjet penale i ofron viktimave mundësinë e të paturit një qasje tjetër ndaj veprës së kryer ndaj tyre, si dhe bën të mundur që ata të ndajnë ndjenja, mendime dhe dëshira. Pjesëmarrja në një diskutim të përbashkët mund t'u japë atyre mundësinë të menaxhojnë frikën, pasigurinë dhe frustrimin e ardhur nga krimi. Njëkohësisht, kjo pjesëmarrje i jep të akuzuarit mundësinë për të marrë përgjegjësi. Duke marrë pjesë në një ndërmjetësim viktimë-i akuzuar, i akuzuari përballlet me pasojat e veprimit të tij dhe merr përgjegjësinë për të reaguar.

Ndërmjetësimi dhe pajtimi janë koncepte të mirënjohura në shoqërinë shqiptare dhe janë përdorur në mënyrë të ndërsjelltë. Sidoqoftë, ka disa ndryshime midis këtyre dy koncepteve. Ndërmjetësimi është një proces i lehtësuar nga një ndërmjetës, ndërsa pajtimi mund të karakterizohet nga negociatat midis dy palëve pa praninë e ndërmjetësit. Përveç ndërmjetësimit dhe pajtimit, drejtësia restauruese është një koncept i ri në shoqërinë shqiptare, i prezantuar pas vitit 1995. Qëllimi i saj është më i gjerë se sa ai i ndërmjetësimit dhe pajtimit. Drejtësia restauruese synon të mbulojë të gjitha masat dhe programet që kanë objektiv riparimin e pasojave të një konflikti dhe pajtimin e palëve në konflikt, që përfshin po ashtu pajtimin dhe ndërmjetësimin.

Të zhvilluara së fundmi, iniciativat e drejtësisë

restauruese përfaqësojnë një nga përpjekjet më kruese për të nxitur marrjen e përgjegjësisë nga i akuzuari për sjelljen e tyre. Ajo gjithashtu u ofron mundësi dhunuesve të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre duke u përballur me viktimën, të riparojnë dhe të zgjerojnë cilësinë e drejtësisë të përjetuar nga viktime dhe nga i akuzuari i veprës penale.

Pjesa e dytë e këtij raporti vlerëson kuadrin ligjor që i referohet drejtësisë restauruese. Kuadri ligjor shqiptar është plotësuar në mënyrë progresive gjatë viteve të fundit me ligje dhe akte nënligjore mbi drejtësinë për të mitur, mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në çështjet penale. Në fakt, masat dhe procedurat nën kuadrin ligjor të të drejtave të fëmijëve, po ashtu janë miratuar dhe rishikuar edhe disa ligje e akte nënligjore për të forcuar drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Ligje të posaçme janë miratuar që rregullojnë ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese për fëmijët e përfshirë në çështjet e drejtësisë penale për të mitur, specifikisht për fëmijët që janë të akuzuar, janë dëshmitarë dhe/ose viktime. Po ashtu, ka ligje të posaçme që ofrojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me orientim tek fëmija viktimë.

Kodi Shqiptar i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), i cili hyri në fuqi në 1 janar 2018, përfaqëson për herë të parë një zhvillim ligjor dhe një ndryshim filozofik në qasjen e trajtimit të fëmijëve brenda sistemit të drejtësisë penale. Ky kod sjell drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin si masa alternative për rehabilitimin e fëmijëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale. Kodi përkufizon konceptet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin si masa dhe procedura, të cilat lejojnë që fëmija në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të riparojë pasojat e veprës penale. Kodi gjithashtu ofron mundësinë për kompensim të dëmit dhe/ose pajton viktimën dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale. Sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, fëmija që ka kryer një vepër penale dhe pala e dëmtuar, marrin pjesë së bashku dhe aktivisht në riparimin e pasojave të veprës penale, nën ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

Siç specifikohet në Kodin e Drejtësisë për të Mitur,

“masa të drejtësisë restauruese” janë të gjitha ato që lejojnë një fëmijë në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të riparojë pasojat e veprës penale, të kompensojë dëmin dhe/ose të pajtohet me viktimën dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale. Në procedurën e pajtimit ose ndërmjetësimit, fëmija që ka kryer vepër penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë aktivisht së bashku në riparimin e pasojave të veprës penale, nën lehtësimin nga ana e një pale të tretë të pavarur.

“Ndërmjetësimi” është procesi jashtëgjyqësor dhe marrëveshja e bazuar në dialog midis fëmijës që ka kryer vepër penale dhe viktimës. Ky proces lehtësohet nga ndërmjetësi dhe synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve, si dhe pasojave të ardhura nga vepra penale e po ashtu përmirësimin e marrëdhënieve midis tyre, pavarësisht nëse është zbatuar ose jo masa e shmangies.

Sipas KDPM, “ndërmjetësimi” është procesi i bazuar në një procedurë jashtëgjyqësore që synon zgjidhjen e konfliktit midis fëmijës që ka kryer vepër penale dhe viktimës. Ndërmjetësimi drejtohet nga një ndërmjetës dhe synon zgjidhjen e konfliktit midis fëmijës e viktimës, si dhe përcaktimin e pasojave që vijnë nga vepra penale. Ndërmjetësimi gjithashtu synon përmirësimin e marrëdhënieve midis fëmijës dhe viktimës, pavarësisht nëse është zbatuar masa e shmangies apo jo. (një masë që shmang fëmijët në konflikt me ligjin nga procedura gjyqësore). Në rastet që përfshijnë fëmijët viktimë, ndërmjetësimi ofron një mundësi të dytë për t’u ndjerë të rehabilituar. Në disa raste, fëmijët vuajnë nga viktimizimi. Prandaj, ndërmjetësimi ndihmon viktimat të ecin përpara dhe të ndihen pozitivë për të ardhmen e tyre. Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi mund të zbatohen në të gjitha fazat e hetimit dhe gjyqimit. Këto procese mund t’i kërkojë i akuzuari, viktimë, prindërit, përfaqësuesit ligjorë ose procedural apo avokatët.

Në rastin kur drejtësia restauruese ose ndërmjetësimi vendoset të zbatohet si një masë shmangie, prokurori ose gjyqtari mund të vendosë ta shmangë të miturin nga procedimi penal. Nëse një masë shmangie merret, prokurori do të vendosë të mos fillojë procedimin penal apo të heqë dorë nga çështja penale, dhe në vend të saj, arrihet një marrëveshje me fëmijën mbi llojin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimit. Pasi marrëveshja për shmangien arrihet, fëmija duhet të zbatohet dhe të përmbushë detyrime që lidhen me

edukimin, kompensimin e dëmit, kryerjen e një kursi për formim profesional, ndjekjen e programeve rehabilituese, të punojë ose kryejë punë në interes publik etj. Zbatimi i marrëveshjes së shmangies monitorohet nga organizatat jo qeveritare ose Shërbimi i Provës dhe çdo problem që lidhet me përmbushjen e detyrimeve nga fëmija, raportohet tek këta aktorë.

Koncepti i “ndërmjetësimit” dhe “ndërmjetësimit viktimë-i akuzuar” janë më të mirënjohura sesa koncepti i drejtësisë restauruese në shoqërinë shqiptare. Kjo vlen jo vetëm për politikëbërësit, por gjithashtu edhe për përfaqësuesit e institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

Që prej vitit 2009, programet e trajtimit dhe rehabilitimit zakonisht janë integruar në programet e Shërbimit të Provës, në bashkëpunim me bashkitë dhe OJF-të. Disa organizata të shoqërisë civile kanë ofruar programe rehabilitimi, por ato janë të varura nga financimet e donatorëve. Programet janë hartuar me qëllim përfshirjen e viktimës dhe të akuzuarit në një mënyrë që e bën të akuzuarin llogaridhënës për çfarë ka ndodhur dhe të riparojë dëmin e shkaktuar ndaj viktimës duke diskutuar për dëmin në një mënyrë që është pjesë e qasjes restauruese.

Sistemi penal shqiptar ka pësuar një ndryshim thelbësor në janar 2018 pas hyrjes në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM). Si pjesë e KDPM, është përfshirë edhe trajnimi specifik për gjyqtarët. Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës (SHM) është mbështetja e profesionistëve në gjykatat dhe prokuroritë shqiptare duke rritur aftësinë e tyre për të zbatuar dhe dhënë vendime për shmangien, masat e sigurisë dhe dënimet për të miturit në përputhje me KDPM dhe legjislativonin për të drejtat e fëmijëve. Trajnimet gjithashtu janë fokusuar në përmirësimin e aftësisë për të analizuar dhe arsyetuar në një mënyrë miqësore për fëmijët kur jepet një vendim e sidomos për shmangien, masat e sigurisë dhe dënimet. Si rezultat, profesionistët marrin në konsideratë praktikën më të mirë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, që përfshin infrastrukturën e nevojshme për të hartuar akte nënligjore, masat alternative të dënimit dhe aktivitete që lidhen me riintegrimin e të miturve në shoqëri, Ministria e Drejtësisë (MD) ka krijuar institucione të reja gjatë viteve 2019-2020.

Një prej këtyre institucioneve është Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, një institucion i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që harton programe parandalimi dhe monitorimi për të miturit për një periudhë 6 mujore pas përfundimit të dënimit. Një tjetër institucion është Institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, i konceptuar si një mekanizëm që do të ofrojë të gjithë programet e rehabilitimit dhe riintegrimin për të miturit me "lirim me kusht" të dhënë nga Gjykata.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit për projektin i-RESTORE është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës që përfshin institucionet politikëbërëse, ministritë që lidhen me akuzuaritetet për mbrojtjen e fëmijëve, agjencitë ligjzbatuese, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë përgjegjësinë dhe ekspertizën në fushën e të drejtave të fëmijëve, në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin.

Një vend i veçantë në raport i është dedikuar jurisprudencës dhe praktikës së institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese, po ashtu të dhënave të mbledhura nga 113 pyetësorë të plotësuar nga profesionistë, si dhe raporteve nga takimet me fokus grupet. Sesioni i fokus grupit me diskutime nga Bordi Këshillues i Fëmijëve, si dhe të dhëna nga fokus grupi e intervista me fëmijë viktime, të cilët kanë marrë pjesë në procedura ndërmjetësimi, përmyll analizën. Ky sesion pasohet nga konkluzionet dhe rekomandimet.

Qeveria shqiptare dhe institucione të tjera kanë një të kuptuar të mirë të politikave të drejtësisë restauruese dhe shërbimeve të ndërmjetësimin. Ata gjithashtu kanë mbështetur praktikën e mira që lidhen me statusin ligjor të ndërmjetësve, siç është përfshirja si

profesion i lirë dhe i licencuar i ndërmjetësit, krahas avokatit dhe noterit. Për më tepër, krijimi dhe veprimtaria e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN) ka kontribuar në qëllimin për mbështetjen dhe monitorimin e specializimit të ndërmjetësve.

Konsolidimi i statusit ligjor të ndërmjetësit dhe krijimi i regjistrin kombëtar të ndërmjetësve në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë lehtëson njohjen dhe promovimin e ndërmjetësve në gjykata dhe prokuroritë e vendit në rastet e procedurave të shmangies në hetimin penal për të mitur. Krahas kësaj, është i rëndësishëm hartimi i programeve të specializimit të ndërmjetësve i bazuar në forma të ndryshme të konflikteve. Specializimi dhe trajnimi i vazhdueshëm ka rritur profesionalizmin e ndërmjetësve. Ministria e Drejtësisë ka mbështetur DHKN në arritjen e marrëveshjeve me Shërbimin e Provës, Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës.

Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje me të gjitha bashkitë në Shqipëri dhe në çdo bashki apo njësi administrative ku ka më shumë se 3000 fëmijë, duhet të ngrihet një grup teknik ndërsektorial për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjatë viteve 2018-2019, trajnime me profesionistë janë organizuar me të gjitha institucionet e drejtësisë penale për të mitur. Numri i trajnimeve ka vijuar të rritet e po ashtu, numri i çështjeve të përfshira në kurrikulën e trajnimit. Asistenca e ofruar nga projekti suedez SIDA, UNICEF janë vetëm disa prej ofruesve të trajnimit. Kurrikula/programet kanë përfshirë 52 oficerë policie, 18 gjyqtarë, 76 prokurorë, stafin e njërive për mbrojtjen e fëmijës, 75 specialistë të Shërbimit të provës, 25 avokatë kryesisht, 9 ndërmjetës, 105 psikologë dhe ekspertë të tjerë.



© Tdh / Grace Medina - Albania

1. Panorama e drejtësisë restauruese në Shqipëri

1.1 Zhvillimi i drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit: vështrim i përgjithshëm historik

Tradita shqiptare ka njohur dhe zbatuar procesin e ndërmjetësimit si një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve në të Drejtën Zakonore (Kanunie)^[1] që prej shekullit të XV në çështjet civile, penale dhe familjare. “Institucioni i faljes dhe pajtimit” është institucioni më i rëndësishëm në Kanun. Rregullat e procedurës të parashikuara në Kanunin e Vjetër mbrojnë të drejtat e të akuzuarit në një formë që edhe qytetarët më të kulturuar në botë do t’i shikonin me admirim. Rregullat e procedurës janë rregulla dhe sjellje të bazuara në parimin e nderit dhe besës. Ndërmjetësit (të ashtuquajturit “njerëz të urtë e të matur”) luanin një rol të rëndësishëm, edhe në rastet e vrasjeve. Nëse ndërmjetësit pohonin se vrasja ishte e paqëllimshme, i akuzuari duhet të paguante vetëm një dënim për marrjen e jetës, si një kompensim financiar për vrasjen.

Kodi i Procedurës Civile dhe Penale i miratuar pas Luftës së Dytë Botërore ka parashikuar ndërmjetësimin si një zgjidhje alternative konfliktesh për vepra të lehta dhe dëme të vogla ekonomike. Praktika kryesore restauruese e përdorur në Shqipëri në të kaluarën

dhe në të tashmen është Ndërmjetësimi Viktimë – I akuzuar (NVA). Në të kaluarën, shërbimi është ofruar nga Këshilla Vendorë të zgjedhura nga komuniteti ose të ashtuquajtur “gjyqtarë popullorë.” Këshillat vendor përbëheshin nga njerëz të moshuar që njiheshin për maturinë, emrin e mirë, personalitetin e fortë dhe sjelljen e ndershme. Këto këshilla vendorë ishin struktura private të përfshira në zgjidhjen e konflikteve përmes negociimit dhe ndërmjetësimit. Gjyqtarët vendorë vepronin si pjesë e sistemit gjyqësor gjatë periudhës së komunizmit dhe zgjidheshin nga komuniteti përmes procesit të votimit të të ashtuquajturave “gjykata të lagjeve” në qytete ose “gjykata të fshatrave” në zonat rurale. Gjyqtarët popullorë të zgjedhur menaxhonin raste që lidheshin me çështje familjare dhe kërkesa civile që përfshinin shuma të vogla parash ose vepra të lehta penale. Në këto raste, ata fillimisht përdornin ndërmjetësimin dhe pajtimin.

Pas rënies së komunizmit në 1995, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë së bashku me Danida, një projekt i Ministrisë së Jashtme Daneze, promovoi ndërmjetësimin si formë alternative e zgjidhjes së konflikteve. Kështu, ata themeluan Fondacionin Shqiptar për Zgjidhjen e Konflikteve (AFCR) me 9 qendra lokale në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me zyrë qendrore në kryeqytetin e vendit, Tirana.^[2] Me

^[1] Kanuni është një kod i së drejtës zakonore shqiptare. Kanuni i Lekë Dukagjinit është kodifikuar në shekullin e 15. 6 versione të tjera të mëvonshme u rishikuan: Kanuni i Vjetër, Kanuni i Mirditës, Kanuni i Pukës, Kanuni i Çermenikës, Kanuni i Pope Julius, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Skënderbeut, i njohur gjithashtu si Kanuni i Arbërisë



mbështetjen dhe ekspertizën e Këshillit të Europës, ligji i parë për ndërmjetësimin u hartua në vitin 1999. Në 2003, një pjesë tjetër e legjislacionit vijoi duke përdorur më gjerësisht ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve ku interesat e fëmijëve janë të përfshira. Aktualisht, shërbimi i ndërmjetësimit rregullohet nga Ligji **Nr.10385, 24.02.2011 “Mbi ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”** dhe ndërmjetësimet ofrohen nga organizata lokale jofitimprurëse dhe ndërmjetës privatë të licencuar nga Ministria e Drejtësisë. Shërbimet ofrohen vetëm në qytetet kryesore dhe zbatohen nga organizatat e shoqërisë civile. Ndërmjetësit janë të licencuar nga Komisioni Kombëtar për Akreditimin e Ndërmjetësve, bazuar në kriteret^[3] e vendosura në ligjin e ndërmjetësimit. Nga 470 ndërmjetës të licencuar (Janar 2020), 89 ndërmjetës janë regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve, që menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë.

Ligji shqiptar për ndërmjetësimin siguron që ndërmjetësimi penal për të gjithë të akuzuarit pavarësisht moshës së tyre (të rritur apo të mitur) të ofrohet në çështje penale ku procedimi penal ka filluar me anë të një kërkese nga ana e palës së dëmtuar. Në çështjet penale, ndërmjetësimi është i zbatueshëm për krime të lehta si plagosje të lehta, fyerje, vepra që lidhen me shkeljet e qarkullimit rrugor të shoqëruara me dëme materjale, goditje, dëme të lehta etj. Veprat më të rënda në parim përjashtohen nga ndërmjetësimi. Në disa raste ka patur çështje ku ndërmjetësimi është realizuar edhe në rastin e vrasjes, konkretisht midis familjes së viktimës dhe personit që ka kryer krimin, në mënyrë që të parandalohet hakmarrja e mëtejshme.

Ndërmjetësimi mund të iniciohet nga gjyqtari, prokurori, profesionistët e administratës së burgut dhe pala e dëmtuar. Në disa raste, ndërmjetësimi i realizuar për krimet e rënda është përdorur për shkak se pajtimi me viktimën konsiderohet një rrethanë ligjore lehtësuese, e cila mund të reduktojë dënimin. Kështu, i akuzuari, inkurajohet të marrë pjesë në ndërmjetësim me viktimën, sepse kjo mund të ulë masën e dënimit

të dhënë, ose mund të çojë në aplikimin e masave të shmangies. Njëkohësisht, interesi i të akuzuarit duhet të përputhet me të drejtën e viktimës për rehabilitim. Ky rregull vlen për të gjithë llojet e ndërmjetësimeve.

Një kategori specifike e konflikteve që mund të zgjidhen me ndërmjetësim janë çështjet e drejtësisë për të mitur. Rekomandohet që ndërmjetësimi penal të zbatohet tek fëmijët dhe të rinjtë që përfshihen në vepra penale. Në raste të tilla mund të propozohet nga prokurori, gjyqtari, ose nga qendra e ndërmjetësimit e lidhur me sistemin e drejtësisë ose me vetë palët. Falë miratimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në mars 2017, është siguruar përshtatja *de jure* e Shqipërisë me standartet ndërkombëtare për drejtësinë për të mitur.^[4]

Gjatë 2018, Zyra e Prokurorisë së Tiranës ka referuar për shmangie 77 raste të miturish dhe ka kërkuar masa alternative (asnjë rast për ndërmjetësim). Nga ana tjetër, Zyra e Prokurorisë së Elbasanit, një bashki në Shqipërinë e mesme, ka referuar 6 raste për ndërmjetësim.

Rastet e të rriturve mund të referohen për ndërmjetësimin i akuzuar-viktimë nga prokurori ose gjyqtari.^[5] Në rastet e të rrituve, Kodi i Procedurës Penale nuk është tërësisht i harmonizuar me ligjin për ndërmjetësimin dhe institucionet (policia, prokuroria, gjykata) janë hezituese për të referuar çështjet penale për ndërmjetësim. Sipas ligjit të ndërmjetësimit, ndërmjetësimi në çështjet penale zbatohet për mosmarrëveshjet e analizuar nga gjykata me kërkesën ose me ankimin e viktimës.^[6] Llojet e çështjeve që mund të zgjidhen me ndërmjetësim janë të kufizuara në ligjin e ndërmjetësimit.

Qendrat sociale u krijuan në Tiranë gjatë vitit 2019 (5 qendra u krijuan përmes bashkëpunimit të Bashkive me Ministrinë e Drejtësisë) ku të miturit në konflikt me ligjin do të përfshihen në programe socializimi të veçanta. Në këto programe të specializuara, pritjet që të përfshihen praktikantët e drejtësisë restauruese.

^[2] FZK ka filluar aktivitetin në 1995 me 26 ndërmjetës të trajnuar dhe që atëherë ka zgjidhur mesatarisht 1800 raste në vit.

^[3] Neni 5 i ligjit shqiptar për ndërmjetësimin ofron kriteret e nevojshme për tu bërë ndërmjetës si: diplomimi në Bachelor në një fushë të paspecifikuar, moshë mbi 25 vjeç, pjesëmarrja në programe trajnimi për ndërmjetës të organizuara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe një dëshmi penalteti pa rekorde kriminale.

^[4] Justice in Matters Involving Children in Conflict with the Law Model Law on Juvenile Justice: <https://bit.ly/2QAmDMj>.

^[5] Për detaje të mëtejshme, ju lutem shihni nenin 12 dhe 14 të ligjit No.10385, 24.02.2011 “Mbi ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” i rishikuar në vitin 2018.

^[6] Për detaje të mëtejshme, ju lutem shihni nenin 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.



2. Kuadri Ligjor

Në vitet e fundit, disa ligje dhe akte nënligjore janë miratuar dhe rishikuar për të forcuar drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin, si masa dhe procedura brenda kuadrit ligjor për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri. Kuadri ligjor i analizuar në këtë studim fokusohet në dy grupe ligjesh:

- Ligjet e posaçme që rregullojnë ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese për fëmijët e përfshirë në drejtësinë për të mitur, si për fëmijët që akuzohen, për ata që janë dëshmitarë e po ashtu për ata që janë viktimë;
- Ligjet e posaçme që ofrojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me fokus tek të drejtat e fëmijës viktimë.

2.1 LIGJE TË POSAÇME ME PARASHIKIME SPECIFIKE PËR NDËRMJETËSIMIN DHE DREJTËSINË RESTAURUESE

Ligji nr. 37/2017 'Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur' (KDPM),^[7] hyri në fuqi në 1 Janar, 2018. Ky ligj fuqizon sistemin e drejtësisë dhe e sjell në linjë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KKBDF) dhe të tjera norma dhe standarte ndërkombëtare që synojnë mbrojtjen e fëmijës në çështjet ligjore bazuar në interesin më të lartë të tij. Shtatë akte nënligjore dhe 5 urdhra ministrorë janë aprovuar në mbështetje të zbatimit të KDPM. KDPM

përfaqëson një zhvillim ligjor të paprecedent dhe një ndryshim filozofik në qasjen e trajtimit të fëmijëve brenda sistemit të drejtësisë penale duke ofruar drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin si masa alternative për rehabilitimin e fëmijëve brenda drejtësisë penale. Kodi ofron në mënyrë të detajuar, të drejtat dhe garantitë procedurale për fëmijët në konflikt me ligjin dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur. Drejtësia restauruese është përfshirë në parashikimet ligjore (Nenet 3/13/14, 14, 34, 44 dhe 61- 64) duke udhëzuar çdo hap procedural në drejtësinë për të mitur. Kodi Shqiptar i Drejtësisë Penale për të Mitur prezanton gjithashtu konceptet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin.

^[7] Janë gjashtë Vendime të Këshillit të Ministrave dhe katër Urdhra të Ministrisë së Drejtësisë si rregullore në zbatim të Kodit Penal për të Mitur lidhur me masat e shmangies dhe ndërmjetësimin, siç janë:

I. Vendimi Nr. 148, datë 20.3.2019 " Për procedurën që zbaton Shërbimi i Provës në rast të mospërbushjes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale ",

II. Vendimi Nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave " Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të mitur".

III. Vendimi Nr. 207, datë 10.04.2019 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e I akuzuariteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin".

IV. Vendimi Nr. 233, datë 17.04.2019 i Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e rregulimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standartet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve".

Siç specifikohet në KDPM, “masat e drejtësisë restauruese” përfshijnë çdo masë që lejon një fëmijë në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë e tij dhe të riparojë pasojat e veprës penale, të kompensojë dëmin dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe të tjerë persona të prekur nga vepra penale. Në procedurën e pajtimit ose ndërmjetësimin, fëmija që ka kryer një vepër penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku e në mënyrë aktive për të riparuar pasojat e veprës penale, zakonisht me asistencën e një pale të tretë të pavarur. “Ndërmjetësimi” është procesi jashtëgjyqësor dhe i bazuar në dialog midis fëmijës që ka kryer vepër penale dhe viktimës. Ky proces drejtohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjet që vijnë nga vepra penale po ashtu përmirësimin e marrëdhënies midis palëve, pavarësisht nëse është aplikuar ose jo masa e shmangies.

“Procedura e ndërmjetësimin” ashtu siç përkufizohet në KDPM zhvillohet me vullnetin e lirë për ndërmjetësim të shprehur si nga fëmija i akuzuar për veprën penale, ashtu edhe nga pala e dëmtuar. Miratimi duhet të jepet në formë të shkruar në praninë e prokurorit.

Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi mund të zbatohen në të gjitha fazat e hetimit ose gjyqimit dhe mund të kërkohen nga i akuzuari, viktimja, prindërit e tyre, përfaqësuesit ligjorë ose proceduralë, avokatët. Në rastet ku vendoset që drejtësia restauruese ose ndërmjetësimi do të zbatohet si një masë shmangie, prokurori ose gjyqtari do të vendosin të shmangin procedurën penale. Nëse një masë shmangie jepet, prokurori do të vendosë të shmangë procedimin penal ose të heqë dorë nga çështja dhe

dhe do të mbyllë çështjen penale me një marrëveshje me fëmijën mbi llojin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin.^[8] Në këto masa shmangie alternative ndaj procedimit penal, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi përfshihen.^[9]

Gjatë hetimit, prokurori dhe gjatë gjyqimit, gjyqtari, kur e shohin të përshtatshme, mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse ata vendosin se kjo është masa më e përshtatshme alternative duke marrë në konsideratë veprën penale, rrethanat e kryerjes të veprës penale, të kaluarën e fëmijës, mundësinë e riparimit të marrëdhënies midis fëmijës dhe palës së dëmtuar, mundësinë e reduktimit të dëmit ndaj palës së dëmtuar dhe mundësinë për të rehabilituar dhe riintegruar fëmijën në shoqëri.^[10] Në fazën e gjyqimit, KDPM zgjeron kompetencën e seksioneve institucionale për të mitur dhe për të rinjtë deri në moshën 23 vjeç. Kodi parashikon që dënimi me burgim për një fëmijë është masa e fundit që zbatohet kur fëmijët kryejnë vepra penale. Është e qartë se zhvillime të tilla në kuadrin ligjor kërkojnë përpjekje të konsiderueshme dhe investim për të siguruar zbatimin dhe koordinimin në mënyrë ndër sektoriale.

KDPM parashikon se një fëmijë në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, ose në procedime administrative dhe civile, ka të drejtën e ndihmës ligjore dhe psikologjike falas të ofruar nga shteti. Kodi gjithashtu parashikon se Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet tu vërë në dispozicion institucioneve një listë me avokatë të specializuar dhe të trajnuar në drejtësinë për të mitur.

V. Vendimi Nr. 314, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.

VI. Vendimi Nr. 541, datë 19.9.2018 “Për miratimin e strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit 2018–2021”.

VII. Urdhri Nr. 7641, datë 05.07.2018, “Për përcaktimin e elementeve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin”, i cili rregullon kushtet, të drejtat dhe detyrimet e marrëveshjes së lidhur midis fëmijës së përfshirë në drejtësinë për të mitur dhe prokurorit ose gjykatësit.

VIII. Urdhri Nr. 368, datë 15.07.2019, “Për miratimin e formatit të raportit për mospëmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin” i cili rregullon modelin e raportit duke u përqëndruar në arsyt, pse detyrimet nuk janë përmbushur dhe pasojat e një përmbushjeje të tillë.

IX. Urdhër Nr. 4950, datë 02.09.2018, “Për vendosjen e modelit të regjistrit për masat alternative të devijimit në çështjet e drejtësisë për të mitur”

X. Urdhri Nr. 367, datë 15.07.2019, “Për miratimin e formatit të planit individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin” ofron llojin e masave të aplikuar, një shpjegim pse masa e zgjedhur konsiderohet efektive, koha periodike për përmbushjen e detyrimeve, mënyra e monitorimit, personat përgjegjës, mënyra e komunikimit me gjykatën, etj.

XI. Dekreti Nr. 6218, datë 7.7.2009, i Presidentit “Për krijimin e Seksioneve Penale për gjykimin e të Miturve pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore” përcakton krijimin e seksioneve në shtatë gjykata: Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Dibër, Krushë, Kurbin, Mat dhe Tiranë. Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Durrës dhe Kavajë. Gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër dhe Tropojë. Gjykatën e rrethit gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Berat, Fier, Lushnjë dhe Vlorë. Gjykatën e rrethit gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Korçë dhe Pogradec; Gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Gjirokastrë, Përmet dhe Sarandë; Gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Elbasan

^[8] Për detaje të mëtejshme, ju lutemi shihni nenin 58/3, 61 dhe 63 të Ligjit Nr. 37/2017. Nenet përkatëse 63 dhe 64 parashikojnë: “Drejtësia Restauruese”.

Ligji nr. 10385, 24.02.2011 “Mbi Ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” (ligji shqiptar për ndërmjetësimin), i rishikuar dy herë, në 2013 dhe në 2018, thekson se ndërmjetësimi mund të zbatohet në çështje civile, familjare dhe penale. Në lidhje me çështjet penale që mund të zgjidhen përmes ndërmjetësimit, ligji i referohet neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale. Ligji shqiptar i ndërmjetësimit parashikon se ndërmjetësimi penal duhet të ofrohet në çështje penale që kanë filluar me kërkesën e palës së dëmtuar. Në çështjet penale, ndërmjetësimi zbatohet për vepra të lehta, që lidhen me shkeljet e qarkullimit rrugor, që përfshijnë dëme materjale, goditje, plagosje të lehta etj. Veprat më të rënda janë përjashtuar nga ndërmjetësimi. Në disa çështje, ndërmjetësimi mund të ofrohet për rastet e vrasjes, midis familjes së viktimës dhe familjes së personit që ka kryer krimin, në mënyrë që të parandalohet hakmarrja e mëtejshme.

Një kategori specifike konfliktesh të mundshme për tu zgjidhur me anë të ndërmjetësimit janë rastet që lidhen me drejtësinë penale për të mitur. Ndërmjetësimi penal rekomandohet të zbatohet kur fëmijët e të rinjtë përfshihen në vepra penale. Në raste të tilla, ndërmjetësimi mund të propozohet nga prokurori, gjyqtari, ose nga qendra që lidhen me sistemin e drejtësisë, ose vetë palët. Ligji “Mbi ndërmjetësimin në çështjet penale” parashikon që gjykata, prokurori ose institucionet shtetërore, do të njoftojnë, udhëzojnë dhe kur është e përshtatshme do të informojnë në mënyrë të qartë e gjithëpërfshirëse palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit.

VKM. 302/25.3.2009 “Mbi organizimin e Shërbimit të Provës,” neni 29 parashikon mundësinë e aplikimit të procedurave dhe programeve të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.^[11]

Ligji nr. 111/2017 “Për Ndihmën Ligjore të garantuar nga shteti” parashikon në nenin 3 se: “ndihma ligjore parësore është: ... (iii) Ofrimi i këshillimit për procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.” Ky parashikim përfshin të drejtën e informacionit për fëmijën e përfshirë në drejtësinë për të mitur.

Ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë,” në nenin 8/gj/h të tij parashikon ndërmjet detyrave që kryen avokati në ushtrimin e profesionit, detyrimin për të informuar klientin për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit, kur e vlerëson të arsyeshme dhe në interes të klientit. Avokati gjithashtu ka detyrimin të informojë viktimën e veprës penale për të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

2.2 LIGJE TË POSAÇME QË OFROJNË MBROJTJEN E FËMIJËVE ME FOKUS TEK TË DREJTAT E FËMIJËS VIKTIMË

1. **Ligji nr. 7895/1995 “Kodi Penal”** ka kaluar përmes një serie ndryshimesh, duke përfshirë përkufizimin e veprave të ndryshme penale, si dhe ofrimin e dënimeve më të rënda për veprat penale në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë abuzimin seksual dhe shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.^[12] Disa nene të Kodit Penal parashikojnë vepra të ndryshme që lidhen me fëmijët viktime. Këto ndryshime kanë harmonizuar legjislacionin penal shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Lanzarotit “Mbi mbrojtjen e fëmijëve

1. Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë. 2. Programi i drejtësisë restauruese, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të zbatohet nëse: a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë; dhe b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme. 3. Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi midis prindërve dhe të miturit, pëlqimin, sipas pikës 2, shkronja “a”, të këtij neni, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të këtij Kodi. 4. Programi i drejtësisë restauruese, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të parashikojë që të miturit t’i kërkohet: a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës; b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë; c) t’i kërkojë falje viktimës; dhe ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktime ose/dhe komuniteti. 5. Masat e drejtësisë restauruese, të marra në përputhje me parashikimet e këtij neni, mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të shmangies dhe ndërmjetësimit, të punës në interes publik dhe/ose çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.

^[9] Për detaje të mëtejshme, ju lutem shikoni nenin 62 të Ligjit Nr. 37/2017.

^[10] Neni 64 i KDM-së gjithashtu parashikon: “... 3. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit I akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar. 4. Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e vlerëson. 5. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit I akuzuar dhe viktimës së veprës penale. 7. Ndërmjetësimi

5. **Ligji nr. 108/2014 “Mbi Policinë e Shtetit”** i ofroi OJF aksesin për të monitoruar dhe vëzhguar ambientet e sigurisë së Komisariateve të Policisë. Për më tepër, **VKM nr. 437/2015 mbi Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve**, e rishikuar, përmban standartet dhe masa të rëndësishme në përputhje me ligjin 37/2017 dhe rregulloret e burgjeve europiane. Çdo institucion në të cilin fëmijët janë të privuar nga liria raporton të dhëna dhe kontakton mekanizmat kombëtarë që operojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Në çdo institucion për të mitur, administrata e burgjeve mban sesione të rregullta informimi për fëmijët dhe shpërndan fletëpalosje mbi të drejtën për tu ankuar dhe procedurat e adresimit të ankimit. Për të ulur nivelin e dhunës, instucionet synojnë të përmirësojnë sigurinë për fëmijët dhe të rrisin cilësinë e shërbimeve të ofruara për ta.
6. **Ligji nr. 22/2018 “Mbi strehimin social”** u miratua në vitin 2018, duke ofruar masa të ndryshme që lejojnë fëmijët viktimë të kenë akses në programet e strehimit social. Programi i strehimit parashikon se fëmijët që janë viktimë të dhunës në familje ose fëmijët e përfshirë në drejtësinë për të mitur të mund të jetojnë në strehëza sociale të specializuara, nëse familja e tyre nuk konsiderohet se është ambient i mirë për edukimin e tyre.
7. **Ligji nr. 7961/1995 “Mbi Kodin e Punës” është rishikuar në 2015 dhe VKM nr. 108/2017 “Mbi mbrojtjen e fëmijëve në punë”** vendos parimet dhe kërkesat për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të fëmijëve nën moshën 18 vjeç nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga çdo lloj pune që mund të dëmtojë sigurinë dhe shëndetin, ose zhvillimin fizik, moral e social dhe që ndikon në edukimin e tyre apo pjesëmarrjen në aktivitete kulturore e tregtare.
8. **Ligji i arsimit parauniversitar u rishikua në vitin 2013**, neni 6/3 parashikon se mbrojtja e veçantë i ofrohet nxënësve dhe studentëve ndaj çdo lloj veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.
9. **VKM nr. 578/2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”** ofron udhëzime për zbatimin efektiv dhe funksionimin e elementeve kyçe në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.^[15]
10. Në qershor 2018, **VKM nr. 353 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njesive administrative”** qartëson rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të grupit teknik ndër-sektorial dhe ofron fuqizimin e bashkëpunimit ndërsektorial në nivel lokal.^[16] Kjo VKM gjithashtu parashikon një procedurë që shpjegon se si rasti i një fëmije të dhunuar do të referohet tek grupi teknik për gjetjen e një zgjidhjeje për situatën.

seksual, shfrytëzimi fëmijës për prostitucion ose praktika të tjera të paligjshme seksuale, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në material pornografik apo abuzim seksual. Neni 27 thekson mbrojtjen e fëmijës nga marrja pjesë në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet, duke e përcaktuar ‘Përmbajtjen e Dëmshme për Fëmijët’. Ligji imponon një detyrim për të gjithë ofruesit e internetit, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat që siguron akses në internet për të aplikuar mjete teknike dhe masa të tjera për të mbrojtur fëmijët nga hyrja në përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme. Bazuar në **VKM Nr. 141/2017**, I akuzuariteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka krijuar një portal që bllokoi hyrjen e faqeve me përmbajtje të paligjshme, për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve. Ligji 18/2017 parashikon krijimin e një linje telefonike falas që të referohen rastet për fëmijët që kanë nevojë për tu mbrojtur. Që nga viti 2012, Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111, një shërbim ky i mbështetur financiarisht nga UNICEF, ka funksionuar dhe po ofron mbështetje në internet për fëmijët. Informacioni mbi ndihmën që ofron linja telefonike përfshihet vazhdimisht në shfaqjet TV dhe fushata, takime dhe trajnime ndërgjegjësuese të kryera nga ALO 116 111 dhe partnerët e saj. Neni 28 parashikon mbrojtjen e fëmijës nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe situata emergjente civile, duke ndaluar përfshirjen e fëmijës drejtpërdrejtë ose indirekte në një konflikt të armatosur. Gjithashtu e rëndësishme është të theksohet që **Ligj 10347/2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” dhe 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”** Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është struktura kryesore për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin lokal. Në vitin 2015, **VKM Nr. 573/2015 “Për Miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve”** përcakton proceset për të cilat bëhet vlerësimi i cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në komunë dhe ofron baza për inspektimin e tyre nga strukturat e nivelit qendror.

^[15] Për herë të parë në Shqipëri, kjo VKM mbulon buxhetimin për ndërhyrje dhe shërbime për mbrojtjen e fëmijëve. Ai përcakton procedurat e referimit dhe siguron shtatë hapa të menaxhimit të procedurës për t’u përgjigjur një fëmije viktimë që ka nevojë për mbrojtje. Pavarësisht përmirësimeve, sfidat mbeten. Edhe pse numri i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve është trefishuar në periudhën raportuese, ato nuk janë themeluar në të gjitha komunat dhe njësitë administrative të cilat kanë më shumë se 3,000 fëmijë.

^[16] Në vitin 2017, strukturat e policisë së Shtetit u ristrukturuan për të përmirësuar përgjigjen ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje. Në Departamentin e Policisë Kriminale të Policisë së Shtetit, ishte themeluar një sektor i të Miturve dhe Dhunës në Familje i përbërë nga një shef sektori dhe dy specialistë. Një specialist dhe një punëtor i specializuar në mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunës në familje janë gjithashtu të vendosur në sektorët e kriminimit të të dymbëdhjetë drejtorive të policisë. Në varësi të territorit që ata mbulojnë, dhe numrin e incidenteve të identifikuar nga komisaritet e policisë, ato kanë një deri në tre oficerë të specializuar në hetimin e krimeve kundër fëmijëve dhe dhunës në familje.



2.3 Kuptimi i përgjithshëm i politikave të drejtësisë restauruese dhe avantazhet e ndërmjetësimit

Konceptet e “ndërmjetësimit” dhe “ndërmjetësimit viktimë-I akuzuar” janë më të njohura në shoqërinë shqiptare sesa koncepti i Drejtësisë Restauruese. Kjo i referohet politikëbërësve e po ashtu përfaqësuesve të institucioneve ekzekutive dhe ligjzbatuese, që kanë më shumë eksperiencë me ndërmjetësimin.

Termi ndërmjetësim është përdorur në kontekstin e proceseve ligjore për sistemin e drejtësisë penale për të rritur, ndërsa termi “riparim” përshkruan praktika të ngjashme në drejtësinë për të mitur. Në praktikë, kjo diferencë në terminologjinë gjuhësore i referohet më shumë kompensimit për viktimat sesa ndërmjetësimin në vetvete.

Një nga qëllimet kryesore të ndërmjetësimit, dhe në kushte ideale një nga rezultatet e ndërmjetësimit në çështje penale, është parandalimi i krimit. Zgjidhja e konfliktit nëpërmjet një marrëveshjeje mes viktimës dhe të akuzuarit në një mënyrë miqësore nënkupton se i akuzuari nuk do të deklarohet fajtor nga vendimi i gjykatës, nuk do të burgoset, nuk do ketë asnjë rekord kriminal apo do të përjashtohet nga të dhënat policore etj. Kjo krijon mundësinë e riedukimit dhe rehabilitimit për I akuzuarin. Në të njëjtën kohë, ajo ndihmon në nivele më të ulta recidivizmi dhe në parandalimin e krimit, pasi korrigjon sjelljen e I akuzuarit. Ndërmjetësimi, përrjedhë, ofron disa përparësi për I akuzuarin. Në anën tjetër, për viktimën, ndërmjetësimi shërben jo vetëm si kompensim i drejtëpërdrejtë për të, nëse palët pranojnë, por viktima përfiton gjithashtu psikologjikisht nga *‘një marrëdhënie e re’* me I akuzuarin, e krijuar përmes takimit. Në fakt, sistemi i ndërmjetësimit mund të duket më i anuar nga I akuzuari, më me interes dhe përfitim për I akuzuarin, por në të njëjtën kohë ndërmjetësimi ndihmon në rehabilitimin dhe/ose kompensimin e viktimës.

Qëllimi i një ndërmjetësimi viktimë-i akuzuar është t’u japë viktimave mundësinë të punojnë me/dhe të ndajnë përvojën e krimit si edhe ndjenjat, mendimet e dëshirat e tyre. Pjesëmarrja në një bisedë të përbashkët mund t’u japë atyre mundësinë e menaxhimit të frikës, pasigurive dhe frustrimit, që mund të krijohet nga krimi i kryer. Ndërmjetësimi i jep të akuzuarit mundësinë për të marrë përsipër

përgjegjësinë. Duke marrë pjesë në ndërmjetësimin viktimë-i akuzuar, i akuzuari përballet me pasojat e krimit të tij/saj dhe mund të ndihet përgjegjës për të reaguar.

2.4 Zbatimi i drejtësisë restauruese tek fëmijët e përfshirë në drejtësinë për të miturit dhe fëmijët viktimë

Që prej 2009, programet trajtuese dhe rehabilituese janë zakonisht të integruara në programet e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me bashkitë dhe OJF-të. Disa organizata të shoqërisë civile mundësojnë gjithashtu programe rehabilitimi, por ato janë të varura nga fondet e donatorëve. Në rradhët e OJF-ve të përfshira në rehabilitim, OJF-të në vijim janë me rëndësi për tu përmendur: Qendra Psiko-Sociale Vatra, Qendra e Shërbimeve Ligjore dhe Praktikave të Integruara, MERIDIA, Shoqëria e Ndhmës Ligjore Tiranë, Sot për të Ardhmen dhe qendra komunitare të koordinuara me OJF-të dhe mbështetura nga donatorët dhe fondet qeveritare. Disa programe rehabilitimi ekzistojnë edhe në qendrat e vuajtjes së dënimit (veçanërisht në Institutin për të Mitur në Kavajë (IMK)). Sidoqoftë, nuk ka asnjë politikë të fokusuar në rehabilitimin e të dënuarve, pasi kanë kryer dënimin.

Qendrat lokale

Qendrat lokale në Shqipëri me detyrë vënien në zbatim të masave alternative dhe rehabilituese për të miturit në konflikt me ligjin, janë të konceptuara si qendra multidisiplinare dhe të vendosura në bashkitë e qyteteve. Qendra e parë e “Ofrimi i Shërbimeve të Ndhmës Juridike Parësore” është inauguruar në qytetin e Elbasanit, aty ku rastet e të miturve trajtohen gjithashtu. Bashkëpunimi ndër-institucional mes sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit lokal është me rëndësi thelbësore për përdorimin e saktë të legjislacionit të drejtësisë për fëmijë. Gjithashtu, në mënyrë që të zbatohen masat alternative të sh-mangies për të mitur në këto qendra multidisiplinare, duhet të vendoset bashkëpunimi midis Shërbimit të Provës dhe strukturave të pushtetit lokal. Tetëmbëdhjetë marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar tashmë mes bashkive dhe Ministrisë së Drejtësisë në mënyrë që të rritet numri i qendrave multidisiplinare.

Qendrat multidisiplinare, të cilat janë të vendosura në

bashkitë e qyteteve dhe kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit, janë tashmë funksionale dhe të hapura për çdo rast të mundshëm referimi nga zyrat e prokurorisë dhe gjykatës. Qendrat multidisiplinare kanë krijuar Grupet Teknike Ndër-Sektoriale (GTN) (shih më poshtë) me punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, avokatë, doktorë e profesionistë të fushave të tjera, të kërkuar sipas vlerësimit të nevojave të fëmijës.

Kur prokuroria vendos për masën e shmangies dhe monitorimin e fëmijës nga Shërbimi i Provës, eksperti i posaçëm merr pjesë në GTN dhe menaxhon çështjen në përputhje me nevojat e fëmijës. Llojet e shërbimit të ofruara për të miturit në konflikt me ligjin mund të ndryshojnë, por mund të përfshijnë individë dhe familje, këshillim social dhe familjar, ndërgjegjësim dhe aktivitete të tjera dhe çdo shërbim tjetër i ofruar nga GTN për të cilat fëmija mund të ketë nevojë. Grupet bashkëpunojnë në mënyrë që të rehabilitohen fëmijët në konflikt me ligjin përmes:

- (i) Ofritit të një sërë shërbimesh gjithëpërfshirëse për fëmijët në qendrat sociale të bashkive;
- (ii) Organizimit të pjesëmarrjes së stafit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Shërbimit të Provës në trajnime të përbashkëta me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të shërbimeve të mbështetjes;
- (iii) Ndhmës lehtësuese dhe mbështetje për fëmijët në konflikt me ligjin dhe familjet e tyre kur kërkohet;
- (iv) Promovimit të modelit të drejtësisë miqësore me fëmijët në konflikt me ligjin përmes aktiviteteve të ndërgjegjësimit, atyre edukuese dhe argëtuese në qendra, në përputhje me nevojat e fëmijës.

Krijimi i Grupeve Teknike Ndërsektoriale (GTN)^[17]

GTN mblihet kryesisht për menaxhimin e rasteve të reja. Në takimet e GTN anëtarët diskutojnë një rast dhe mënyrat si mund të zbatohen masat mbrojtëse. Në rastet me një nivel të lartë ose të menjëhershëm

rreziku, ata mund të zbatojnë “Masat Emergjente të Mbrojtjes” dhe “Masën Mbrojtëse të Mbikqyrjes së Specializuar në Ambjentin Familjar.” GTN gjithashtu menaxhon raste që janë trajtuar në një fazë të mëparshme dhe ku planet individuale të mbrojtjes së fëmijës të hartuara më parë, duhet të rishikohen. GTN në Tiranë, Kamëz, Elbasan, Korçë, Maliq, Pogradec, Kuçovë dhe Durrës raportojnë se të gjitha njësitë administrative kanë mbajtur të paktën një takim çdo tre muaj. Sidoqoftë, për situata emergjente GTN kanë organizuar më shumë takime. Në një rast, këto kanë ndodhur edhe brenda një muaji. Disa vështirësi dhe sfida, që janë konstatuar në kuadër të funksionimit të GTN, lidhen me zëvendësimin e ekspertëve që marrin pjesë në takime, sidomos nga institucionet shtetërore. Në këtë aspekt, janë raportuar mungesë vazhdimësie, pjesëmarrje jo e rregullt dhe mos konformizëm me detyrat.

Një sfidë tjetër është se në disa bashki nuk ka organizata jofitimprurëse që ofrojnë ekspertizë për shërbimet për fëmijët që janë në mbrojtje. Minsitria e Drejtësisë ka hartuar plane pune me donatorë të ndryshëm që ofrojnë shërbime të specializuara dhe trajnime në fushën e drejtësisë penale për të mitur në mënyrë që të mbulojnë dhe menaxhojnë të gjitha aktivitetet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur të zbatuar nga Minsitria e Drejtësisë.

2.5 Iniciativa të tjera që lidhen me fëmijët viktime

a. Krijimi i Institucioneve të reja dhe përfshirja e strukturave të reja për fëmijët në institucionet egjistuese

Ministria e Drejtësisë është e angazhuar të krijojë institucione të reja, të cilat do t'i përmbahen kërkesave të KDM. Ky angazhim mund të shihet në këto shembuj:

- Qendra e Parandalimit të Krimit për të Mitur dhe të Rinj,^[18] një institucion i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i

^[17] Bazuar në Ligjin 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", pjesëmarrësit e tjerë kanë qenë prindër, përfaqësues të shoqërisë civile, Departamenti të Shëndetit Publik dhe Zyrës së Punësimit.

^[18] Një institucion i tillë është planifikuar që fillimisht të ketë një staf me 16 anëtarë. Paketa e dokumenteve administrative, përshkrimi i punës, rregullat e brendshme dhe ato të funksionimit, plani një vjeçar i punës, modelet e riintegritit dhe rehabilitimit dhe gjithashtu aktet e brendshme administrative janë hartuar tashmë. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve fillon të funksionojë në vitin 2020.

cili do të krijojë programe parandaluese dhe do të monitorojë të miturit për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të dënimit.^[19]

- Institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit për fëmijët,^[20] është një institucion i konceptuar si një mekanizëm ku të zhvillohen të gjitha programet e rehabilitimit dhe riintegrit për të miturit e dënuar nga Gjykata me “liri të kufizuar”. Institucionet e Kufizimit të Lirisë janë konceptuar për të funksionuar si institucion gjysëm të hapura ku liria e veprimit/lëvizjes për të miturit kufizohet në një nivel që t’i parandalojë ata nga kryerja veprave penale. Këto institucione synojnë veçanërisht të riintegrojnë dhe të risocializojnë të miturit në komunitet. Një procedurë e veçantë duhet të ndiqet nga stafi i institucionit në kontekstin e risocializimit për të miturit. Kjo procedurë bazohet në programet e përgjithshme të edukimit/rehabilitimit të përgatitura nga vetë institucioni, si edhe nga programi individual i trajtimit bazuar në vlerësimin e nevojave të veçanta të secilit të mitur dhe të metodave të ndërhyrjes.^[21]

Zhvillimi dhe funksionimi i këtyre dy institucioneve kanë si qëllim t’i shërbejnë trajtimit të të miturve në përputhje me standartet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të tyre, duke synuar edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.^[22]

b. Krijimi dhe zhvillimi i Sistemit Elektronik i të Dhënave për Drejtësinë Penale për të Miturit

Sistemi Digjital i të Dhënave për Drejtësinë Penale për të Miturit është një sistem elektronik, i cili kryen ndjekjen e rasteve në mënyrë hap pas hapi dhe pas secilës fazë të mundshme. Gjithashtu, ai gjeneron të

dhëna statistikore në kohë reale.^[23] Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë së bashku me Agjencinë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit po përgatit modalitetet për ngritjen e këtij sistemi duke marrë në konsideratë modelin e ndërtuar nga UNICEF për këtë qëllim. Aktualisht, të gjitha procedurat teknike dhe administrative janë kryer dhe përgjatë 2020 do të fillojë zbatimi. Gjatë vitit 2020, takime të përbashkëta, tryeza diskutimi dhe takime pune do të mbahen me të gjithë aktorët zbatues për të diskutuar detajet e funksionimit dhe përdorimit të sistemit.^[24]

c. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe grupeve të tjera të interesit

Marrëveshje me Bashkitë e Republikës së Shqipërisë

Vlen të përmendet se Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në lidhje me programet DR për të miturit me OJF-të, të cilat synojnë modelimin e shërbimeve riintegruese për të miturit të cilët janë në konflikt me ligjin. Këto marrëveshje janë lidhur për të forcuar dhe rritur kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e modelit të DR. Modeli të DR do të zhvillohet përgjatë 2020-2022 në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Bashkinë Tiranë, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Qendrën e Formimit Profesional dhe institucione të tjera.

Shërbimi i Provës ka filluar tashmë të zbatojë marrëveshjet e bashkëpunimit me bashki të ndryshme të vendit me qëllim monitorimin e të miturve, të cilët janë nën masa shmangieje. Në bashki të ndryshme janë krijuar 29 qendra komunitare, të cilat zbatojnë këto masa.

^[19] Pas monitorimit të drejtpërdrejtë nga Ministria e Drejtësisë të strategjisë së aplikimit, ka treguar se: (*) Synimi për vitin 2019 ishte - 30% e rasteve të të miturve / të rinjve të jenë rehabilituar, por objektivi nuk është arritur plotësisht. (*) Synimi i planifikuar për vitin 2020 ishte një rritje prej 75% e rasteve të rehabilituar të mitur/ të rinjve krahasuar me 2019 dhe (*) për 2021 ata planifikuan 95% më shumë raste të të miturve / të rinjve të rehabilituar sesa në vitin 2020.

^[20] Vendimi Nr. 233, datë 17.04.2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standarteve të programeve të edukimit dhe rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë për të miturit” është miratuar.

^[21] Një institucion i tillë është planifikuar që fillimisht të ketë 34 anëtarë pjesë e stafit që të trajtojnë 20 të mitur. Për momentin (shkurt 2020) ekziston një proces vlerësimi për të zgjedhur vendin si pozicion gjeografik (Tiranë / Mezes) dhe infrastrukturën për të krijuar një institucion të tillë

^[22] Qëllimi i këtyre institucioneve është që të miturit në konflikt me ligjin të trajtohen pa u izoluar, përmes programeve të përshtatshme të edukimit, rehabilitimit dhe riintegrit në komunitet dhe shoqëri dhe të shmangët ripërfshirja e tyre në krim, si dhe të reduktohet recidivizmi. Një fond investimi me linja të buxhetuara për vitet 2019/2020/2021/2022 është parashikuar/inicjuar.

^[23] Krijimi i sistemit të integruar është një detyrim ligjor që rrjedh nga neni 136 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili parashikon se, “Sistemi Digjital i të Dhënave për të Miturit në drejtësinë penale” krijohet me qëllim ruajtjen e të dhënave për rastet penale që përfshijnë të mitur në konflikt me ligjin, të mitur viktimë dhe të mitur dëshmitar të veprave penale”. Kodi dhe 24 VKM nr. 149, e datës 20.03.2019, ngarkojnë Ministrin e Drejtësisë me administrimin e të dhënave të këtij sistemi.

Gjatë vitit 2019, u realizua pilotimi i një qendre edukuese/ rehabilituese për të miturit me liri të kufizuar dhe u krye standartizimi i tre modeleve të planeve të cilat u përgatitën nga IMK/ punonjës të paraburgimit. Gjithashtu, qendra përgatiti modele, të cilat janë përdorur nga projekti Suedez *“Rritja e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare të zbatimit të ligjit dhe gjykatave në përmbushjen e standarteve të drejtësisë për të miturit-mbështetje e integruar në zinxhirin e drejtësisë”*. Këto modele janë: Modeli i vlerësimit të rrezikut dhe nevojës sipas rrezik-nevojë-reagim (RNR), puna njohëse e sjelljes, zgjidhja e problemit dhe aftësitë sociale; Modeli i Planit Individual të Trajtimit bazuar në rezultatet RNR; Modeli i referimit për mekanizmin riintegruar.

2.6 Drejtësia resturuese dhe ndërmjetësimi në sistemin arsimor: shkollat

Vendimi i Parlamentit nr. 47/2019 “Për miratimin e Strategjisë së edukimit ligjor të publikut 2019-2023” parashikon që informacioni rreth legjislacionit fillon në shkolla, në përputhje me moshën dhe aftësinë e fëmijëve. Është thelbësore që fëmijët të familjarizohen me legjislacionin që adreson të drejtat e tyre dhe mbrojtjen, si dhe që ky informacion të bazohet tek mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse që garantojnë ushtrimin, monitorimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Fëmijët duhet të njihen jo vetëm me të drejtat, por gjithashtu edhe me detyrimet e tyre, në mënyrë që të ndërgjegjësohen se janë subjekt i ligjit, ashtu si të rriturit. Ata gjithashtu duhet të informohen mbi masat e nevojshme për të parandaluar përfshirjen e tyre në grupet e ekstremizmit të dhunshëm.^[25]

Ndërgjegjësimi mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndikon për të mbajtur nxënësit dhe studentët larg nga vetë-gjyqësia dhe hakmarrja, duke

parandaluar kriminalitetin dhe sjelljen e paligjshme. Rritja e ndërgjegjësimit midis studentëve mbi avantazhet e ndërmjetësimit përmes organizimit të fushatave publike të edukimit, është gjithashtu çështje për tu adresuar me nxënësit e shkollave.

Ministria e Arsimit ka ndjekur një seri aktivitete me temën: *“Prirjet e drejtësisë restauruese – një alternativë për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin,”* si pjesë e një programi *“Angazhimi i shoqërisë civile në krijimin e praktikave të drejtësisë restauruese për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin.”*^[26]

Programme të veçanta që synojnë promovimin e edukimit, rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve janë zhvilluar për të gjithë të miturit në Institutin për të Mitur në Kavajë. Gjatë 2019, 25% e të miturve dhe prindërve në Institucion kanë përfutuar nga programet e drejtësisë restauruese, edukuese dhe riedukuese. Në 2020, Ministria e Drejtësisë ka planifikuar të rrisë numrin e fëmijëve dhe prindërve të trajnuar me 50% krahasuar me 2019.

Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka hartuar 22 programe në lidhje me drejtësinë restauruese për klasat e 1-5 dhe nga 6-9 në institucionet e të miturve.^[27]

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, Terre des Hommes ka zhvilluar aktivitete, ku 291 nxënës dhe mësues në shkollat e mesme të Tiranës, Korçës dhe Gjirokastrës janë informuar rreth parimeve të drejtësisë restauruese për të mitur. Një tjetër aktivitet ishte krijimi i një rrjeti lokal, me pjesëmarrjen e 133 personave për të zhvilluar aftësi restauruese për të miturit në konflikt me ligjin në Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Terre des hommes ka kryer trajnime për rritjen e kapaciteteve të 20 ndërmjetësve dhe është në procesin e përgatitjes së udhëzuesve për punonjës policie, psikologë dhe avokatë.

^[24] Do të jenë 49 institucione që do të përdorin këtë sistem. Llogaritja e numrit të institucioneve është bërë duke u bazuar në sektorët ekzistues të drejtësisë për të mitur: 7 gjykata, 7 prokurori, 12 struktura policore, 22 zyra të pushtetit lokal, 1 IEVP për të mitur.

^[25] Analiza e Sistemit të Drejtësisë e bërë nga Parlamenti gjatë procesit të reformës ligjore 2016-2018 ka theksuar nevojën e përfshirjes së edukimit ligjor në lëndët thelbësore të arsimit parauniversitar dhe për të pasuruar më tej kurrikulat dhe aktivitetet jashtëshkollore të sistemit arsimor parauniversitar me elementet e edukimit juridik në fushën juridike. Gjithashtu është e nevojshme të trajnohet stafi pedagogjik me nivelin e duhur të njohurive juridike, duke ju dhënë kurse të detyrueshme të arsimit juridik në kurrikulën universitare të fakulteteve që përgatisin mësuesit.

^[26] Gjashtë seanca sensibilizuese janë mbajtur në shkollat e mesme “Petro Nini Luarasi”, “Partizani”, “Myslym Keta”, “Qemal Stafa”, “Raqi Qirinxi”, dhe “Siri Shaplllo” (në qytete të ndryshme). Aktivitetet u mbështetën nga Bashkimi Evropian dhe kryen nga Terre des hommes në partneritet me AFCR. Gjatë vitit 2019, janë mbajtur dhjetë programe / aktivitete në institucionet arsimore.

^[27] Këto programe janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe janë publikuar në faqen e ASCAP: <https://www.ascap.edu.al/>.



World Vision

Lidhur me rritjen e kapaciteteve të ekspertëve për të punuar me të miturit, World Vision ka realizuar katër trajnime me përfaqësues të autoriteteve lokale, që luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, po ashtu aktorë të tjerë, si Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), shërbimet sociale, administrator dhe psikologë shkollash. Trajnimet janë fokusuar në *“Zgjerimi i aksesit në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes ofrimit të shërbimit ligjor falas”* në Korçë, Librazhd, Lezhë dhe Kurbin. Ato u ofruan gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2019. Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek nxënësit dhe mësuesit në shkolla, World Vision ka organizuar takime informuese mbi edukimin ligjor me nxënës të shkollave të mesme në Korçë, Librazhd, Lezhë, Kurbin dhe Kamëz gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2019.

Komiteti i Helsinkit

Iniciativa e Komitetit të Helsinkit Hollandë në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit synon të kontribuojë në sistemin penitenciar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut duke përmirësuar mundësitë për të miturit e burgosur për tu integruar suksesshëm në shoqëri përmes prezantimit të metodave zyrtare të punës për stafin e burgjeve dhe integrimin e këtyre metodave në politikat zyrtare dhe institucionet e edukimit. Gjithashtu, ekspertë nga Universiteti Leiden në Hollandë përdorën Instrumentin e Klimës Sociale me Fakultetin e Shkencave Sociale, Tiranë, për të trajnuar profesorët dhe studentët e këtyre personave me metoda të praktikuara, si dhe zhvillimin e të miturve të akomoduar në institucione të mbyllura, të tilla si IM në Kavaje.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Gjatë vitit 2019, me mbështetjen e projektit suedez *“Rritja e kapaciteteve në institucionet dhe gjykatat shqiptare në përmbushjen e standardeve të drejtësisë për të mitur-një – mbështetje e integruar në zinxhirin e drejtësisë,”* disa modele (siç u përmend më lart) janë hartuar ose përmirësuar në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur: (*) Format i vlerësimit të nevojave dhe riskut në përputhje me modelin RNR, punën konjitive-bihejviorale, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë sociale. (*) Format i Planit Individual

të Trajtimit bazuar në rezultatet e RNR; (*) Format i mekanizmit të referimit për riintegrim. Formate të tilla janë përdorur me të miturit në Institucionin e Kavajës (aktualisht 23 të mitur).

Programi i Trajnit Individual: (*) programi edukues për arsimin e detyrueshëm dhe atë të shkollës së mesme; (*) program i i trajnimit profesional përmes kurseve profesionale dhe të punësimit; (*) Programi i zhvillimit të aftësive pro-sociale dhe menaxhimit të zemërimit; (*) Programi i prezantimit mbi të menduarin; (*) Programi i terapisë së artit dhe sportit; (*) Programi i prindërimit në distancë në mënyrë që të forcohen lidhjet familjare; (*) Programi për zgjidhje konflikti dhe ndërmjetësim dhe parandalim të dhunës; (*) Programi You-Turn për krijimin e rrjeteve mbështetëse në komunitet për të parandaluar recidivizmin e mundshëm; (*) Programi i parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit; (*)

Krahas programeve ekzistuese informuese, administrata e Institutit për të Mitur Kavajë ka organizuar sesione informuese ndërgjegjësuere me të miturit dhe prindërit e tyre mbi të drejtat dhe mundësitë e ofruara për rehabilitim dhe riintegrimin e tyre. 100% e të miturve në Institutin e të Miturve Kavajë dhe 60% e prindërve të tyre janë informuar mbi të drejtat e fëmijëve dhe zbatimin e drejtësisë miqësore për fëmijët.

2.7 Përmbledhje e trajnimeve mbi drejtësinë miqësore për fëmijët

Sistemi i drejtësisë penale në Shqipëri ka kaluar përmes ndryshimesh të rëndësishme që prej janarit 2018 me hyrjen në fuqi të KDM. Trajnime janë realizuar për profesionistët në Gjykatat dhe Prokuroritë Shqiptare mbi KDM me qëllimin specifik për të rritur kapacitetet e këtyre profesionistëve për të zbatuar dhe për të marrë vendime lidhur me shmangien, masat e sigurisë dhe dënimet për të miturit në përputhje me KDM dhe ligje të tjera që lidhen me të miturit. Trajnimet po ashtu kanë synuar të rrisin kapacitetet e këtyre profesionistëve për të analizuar dhe arsyetuar vendimet për shmangie, masa sigurie dhe dënime që trajtojnë të miturin në mënyrë miqësore, duke marrë në konsideratë praktikën më të mira gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare.

During 2019, training with penal justice for minors institutions continued and the number of issues included

in the training curricula increased.^[28] Assistance was provided through the Swedish Project with UNICEF and others. Drafting of the curricula/training programmes were addressed to: police officers, judges, prosecutors, Local Agency for Children's Rights staff, probation service personnel, prisons, lawyers, mediators, psychologists and other experts.

Institucionet që kanë përgjegjësi në trajnimin e ekspertëve janë:

- Shkolla e Magjistraturës;
- Akademia e Sigurisë;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Urdhri i Psikologut/i Punonjësit Social;
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Shërbimi i Provës.

Trajnimi i Gjyqtarëve

Bazuar në vendimin **Nr. 79, date 30.05.2019**, KLGJ vendosi rregullat për zgjedhjen e gjyqtarëve që lidhen me çështjet e të miturve në Gjykatë. Ky vendim shërben po ashtu për të përcaktuar këshillat gjyqësorë dhe për të përditësuar listën e gjyqtarëve të specializuar në drejtësinë penale për të mitur dhe trajnimin e tyre vazhdues. Gjatë viteve 2018-2019, Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me KLGJ dhe programin e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit (SIDA), si dhe OSBE kanë trajnuar 208 gjyqtarë dhe 51 kandidatë të diplomuar për magjistratë (me profil gjyqtari).

Trajnimi i Prokurorëve

Prokuroria e Përgjithshme me urdhrin e saj nr. 27 të datës 21.02.2019 ka miratuar strukturën organike të prokurorive të rrethit dhe atë të prokurorive të apelit. Si rezultat, prokuroritë e rretheve kanë 26 koordinatore. Këta koordinatorë janë punonjës socialë ose psikologë të ngarkuar për të asistuar të miturit dhe dëshmitarët e mbrojtur gjatë hetimit fillestar.

Shkolla e Magjistraturës, në total, ka trajnuar 103 persona në bashkëpunim me projektin e SIDA. Më konkretisht, mbi çështjet e të miturve në këto grupe kanë marrë trajnim të specializuar: 76 magjistratë me profil prokuror; 18 magjistratë të diplomuar (Jo të nominuar kur janë trajnuar); 2 këshillëtarë në DPP dhe 7 oficerë të Policisë Gjyqësore. Gjatë vitit 2019, shkolla e Magjistraturës ka mbajtur 11 aktivitete trajnuese mbi drejtësinë penale për të mitur ku prokurorët dhe gjyqtarët kanë marrë pjesë.^[29]

Urdhri i Psikologut, në bashkëpunim me UNICEF, ka mbështetur hartimin e një serie broshurash informuese për prokurorë dhe gjyqtarë mbi rolin e psikologut në proceset civile, familjare dhe penale ku një i mitur është i përfshirë. Këto broshura synojnë lehtësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional midis magjistratëve dhe psikologëve dhe krijojnë pritshmëri të qarta për ekspertët në punën e tyre.^[30]

Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA), bazuar në Ligjin për Ndihmën Ligjore, por gjithashtu në Ligjin për Profesionin e Avokatit në bashkëpunim me Këshillin e Europës, përmes Programit European për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për profesionet ligjore (HELP),^[31]

^[28] Në vitin 2020, Evropa, së bashku me pjesën tjetër të botës, u përball me një krizë globale pandemike për shkak të Covid-19, i njohur gjithashtu si virusi korona.

^[29] Gjashtë nga aktivitetet u mbajtën në bashkëpunim me SIDA gjatë aplikimit të "Programit Shqiptaro-Suedeze për Drejtësinë Penale për të Mitur" dhe një tjetër me Karitas. Temat kryesore ishin: 1) Drejtësia penale për të miturit. Standardet ndërkombëtare mbi parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe inovacionet e Legjislacioni shqiptar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur); 2) Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve; 3) Qëndrim procedural mbi të miturit gjatë procesit penal sipas kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit; 4) Shmangia nga hetimi penal i të miturve në konflikt me ligji; 5) Të drejtat procedurale të të miturit në konflikt me ligjin; 6) Komunikimi dhe marrja në pyetje i të miturve nga gjyqtarët / prokurorët; 7) Arsyetimi ligjor i dënimeve penale; 8) Krijimi i kapaciteteve të institucioneve për të mbrojtur fëmijët shqiptar që gjenden në rrugë dhe shfrytëzohen për punë në vendet fqinje".

^[30] Ato janë shpërndarë në çdo gjykatë dhe zyrë prokurorie, dhe gjithashtu mund të gjenden në internet në: <https://uni.cf/3lyi97a>.

^[31] See: www.coe.int/help.

^[32] Kursi u mbajt nga data 3 maj deri në 5 korrik 2018 dhe përbëhej nga 9 module: (1) Hyrje: të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe drejtësia miqësore për fëmijë; parime dhe koncepte; (2) Drejtësia miqësore për fëmijë: para, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore; situata të veçanta për tu mbajtur në vëmendje; (3) Procedimet jogjyqësore: përkufizimet dhe arsyet për të inkurajuar procedimet jo gjyqësore; format dhe fazat e procedurave; garancitë dhe kushtet; këshillat ligjore, mbështetja dhe përfaqësimi ligjor; (4) Elemente të përgjithshme: privatësia; masat mbrojtëse; organizimi i ambientit; e drejta për përfaqësim ligjor; përfaqësimi ligjor; (5) Ndërveprimi me fëmijët në sistemin e drejtësisë – sfidat kryesore: moshë e të kuptuarit; gjinia; statusi; vulnerabiliteti; pjesëmarrja; (6) Ndërdisciplinat: hyrje (arsyet kryesore për qasjen ndërdisciplinore); puna në grup dhe bashkëpunimi; identiteti dhe ndërprofesionalizmi; (7) Privimi i lirisë: përkufizime dhe parime; kushtet e burgimit; riintegrimi; monitorimi dhe mekanizmat e ankimit; (8) Dhuna kundër fëmijëve: hyrje dhe kuadër ligjor; përkufizimi dhe tipologjia e dhunës kundër fëmijëve; trajtimi i viktimave të dhunës brenda sistemit gjyqësor; (9) Migrimi dhe azili: të drejtat specifike të fëmijëve në migrim; fëmijë të pashoqëruar; ribashkimi familjar; burgosja dhe monitorimi; procedimet administrative.

organizoi kursin e Drejtësisë Miqësore me Fëmijët dhe të Drejtat e Fëmijëve, duke trajnuar 25 avokatë nga gjithë Shqipëria mbi KDM dhe mbrojtjen e fëmijëve.^[32]

Kursi i HELP i Këshillit të Europës përdori metodologjinë e HELP^[33] në bashkëpunim me Divizionin e të Drejtave të Fëmijëve të Këshillit të Europës, stafin e përfaqësuesit të veçantë të KE për migracionin dhe refugjatët dhe Komisionierin e Lartë për Refugjatët për Kombet e Bashkuara (UNHCR).^[34] Një tjetër trajnim online përmes programit të HELP është dakortësuar me KE për të trajnuar 30-35 avokatë mbi drejtësinë miqësore për fëmijët dhe KDM.^[35]

Që prej vitit 2018, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është përfshirë si një modul i veçantë në Shkollën e Magjistraturës. Në mars 2019, Dhoma Kombëtare e Avokatisë nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Terre des Hommes (Tdh) për: (*) hartimin e një udhëzuesi për avokatë mbi *“Drejtësinë miqësore për fëmijët dhe Drejtësinë Restauruese”*; (*) Hartimin e një kurrikule trajnimi bazuar në udhëzimet për asistentë avokatët në Shkollën e Avokatisë dhe (*) për të zhvilluar në mars 2020, një trajnim në përfundim të marrëveshjes; *(shtyrë për shkak të pandemisë së koronavirusit)*.

Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me UNICEF, ka bashkëpunuar që prej 2009 mbi parimet dhe udhëzimet për avokatët që ofrojnë ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Udhëzuesi i prodhuar është përkthyer në Shqip dhe do të shpërndahej në 2020. *(Shtyrë për shkak të koronavirusit)*.

Trajnimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për 150 persona të stafit

Gjatë vitit 2018, një kurrikulë trajnimi u hartua për stafin e burgjeve që punon me të miturit në kuadër të projektit të BE-KE “Forcimi i të drejtave të të Burgosurve në Shqipëri” në kuadër të projektit “Programi i Mbështetjes Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë – Faza I”. Ky trajnim filloi të zbatohet në 2019.^[36]

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe TDH ka hartuar kurrikula për trajnimin e Punonjësve të Mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal sa i përket risive ligjore dhe përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së fëmijës, duke përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin. Kurrikula e trajnimit pritet të miratohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Ky institucion do të trajnojë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe punonjës civilë të fushave të ndryshme në mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin.^[37]

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, **Akademia e Sigurisë** organizoi sesione të ndryshme trajnimi dhe trajnoi 53 oficerë policie mbi teknikat miqësore të punës me fëmijët.^[38] Duke marrë në konsideratë faktin se Njësia e Hetimit për të Mitur po kërkon një qasje të re, duke përfshirë një procedurë të veçantë të dokumentimit të hetimit, një procedurë e re e hetimi “Për teknikat e të miturve” dhe përdorimi i pajisjeve audio-video të regjistrimit janë të nevojshme.

[32] Shih: <http://help.elearning.ext.coe.int/course/index.php?categoryid=16>.

[34] Gjatë vitit 2019 (8-10 korrik), janë mbajtur trajnime për përmirësimin e njohurive të avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike në bashkëpunim me Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë (TLAS) dhe me mbështetjen e Dhomës së Avokatisë Amerikane (ABA ROLI). Disa tema të përfshira kanë qenë: 1) Ligji “Për ndihma juridike e garantuar nga shteti”; 2) Riset dhe ndikimi në procesin penal, kategoritë e përfutësve, roli i avokatit të ndihmës juridike; 3) Parimet e rëndësishme gjatë procesit penal, çështje nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut; 4) Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, garantitë procedurale për të miturit.

[35] Shumica e këtyre avokatëve do të jenë nga lista e ndihmës juridike (sipas detyrës zyrtare) dhe do të përzgjidhen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ishte planifikuar që gjatë muajve Shkurt-Mars 2020 do të mbahej trajnimi i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike nëpërmjet Programit HELP në internet me 40 avokatë. Shoqata Shqiptare e Avokatëve Antikorrupsion mblodhi aplikime nga avokatët e interesuar në mënyrë që të zgjidheshin 40 për të ndjekur trajnimin e programeve online HELP. Për shkak të situatës së koronavirusit ky trajnim është shtyrë. Në prill të vitit 2020, ishte planifikuar një takim ballë për ballë midis 40 avokatëve dhe ekspertit të Këshillit të Evropës, sidoqoftë dhe ky takim gjithashtu u shty.

[36] Kurrikula përmban dymbëdhjetë tema specifike që mbulonin sistemin e drejtësisë për të miturit. Gjatë vitit 2019 kurrikula u shoqërua me trajnimin e stafit të të gjithë institucioneve të drejtësisë penale për të miturit dhe trajnimet që nga ajo kohë janë mbajtur me 60% të ekspertëve.

[37] Gjatë 25-26 Prill 2019, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave partnere, mbajti një konferencë me temë “Koalicioni Kombëtar për të mbështetur punonjësit që mbrojnë fëmijët”. Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i risive ligjore në dosjen e mbrojtjes së fëmijëve. Në konferencë morën pjesë rreth 150 punëtorë që mbrojnë fëmijët nga 61 bashkitë, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, dhe gjithashtu përfaqësues të UNICEF, OSBE, ËV, TDH, SHKK. Gjatë konferencës u prezantuan risitë ligjore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë dhe përgjegjësitë e reja për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve.

[38] Akademia e Sigurisë organizoi dy seminare me temë: “Seminar ndër-institucional për të miturit në konflikt me ligjin” (maj 2019) me pjesëmarrja e gjashtë

Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me UNICEF, ka trajnuar 75 punonjës të Shërbimit të Provës gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019 mbi drejtësinë restauruese për të mitur dhe u investua në bashkëpunimin e tyre me ndërmjetës për monitorimin e marrëveshjeve i akuzuar-viktimë (kur të paktën njëra nga palët është e mitur). Kualifikimi dhe trajnimi i këtyre punonjësve u realizua gjatë një trajnimi dy ditor dhe një workshop-i një ditor. Kombinimi i aktorëve të ndryshëm lehtësoi dhe përcolli njohuritë dhe i dha nxitje veprimeve të duhura. Kjo u realizua përmes krijimit të një rrjeti komunikimi dhe shkëmbimit të eksperiencave midis punonjësve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës. Gjatë vitit 2019, Shërbimi i Provës trajnoi 25 punonjës në kuadër të projektit Shqiptaro-Suedez për Drejtësinë e të Miturve.

Oficerët e policisë dhe prokurorët janë trajnuar mbi teknikat për të hetuar krimet e kryera nga të miturit, teknikat e intervistimit të fëmijëve, masat e shmangies dhe drejtësinë restauruese, Kodin e Drejtësisë Penale dhe programet e rehabilitimit, riintegrimin e fëmijëve të përfshirë në drejtësinë për të mitur, bashkëpunimin ndër institucional rreth referimit të rasteve që përfshijnë fëmijë viktimë, dhe të drejtat dhe garancitë e fëmijës në procedurat e drejtësisë për të mitur.

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për të garantuar funksionimin e ligjeve të reja dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi, si dhe në diskutimet ndër-institutionale të grupit të punës të krijuar me këtë qëllim, Urdhri i Psikologut identifikoi të gjithë psikologët e specializuar në drejtësinë për të mitur (bazuar në trajnime të veçanta ose eksperiencë pune), në mënyrë që të hartonte dhe përditësonte module trajnimi dhe programe për këtë kategori psikologësh. Në maj 2018, Urdhri i Psikologut **në Republikën e Shqipërisë filloi trajnimin e veçantë (130 orë) për 107 psikologë asistues dhe vlerësues në sistemin e drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, universitetet publike dhe jopublike, Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë**, programi suedez SIDA dhe OJF e shoqërisë civile. Trajnimi u zhvillua gjatë periudhës maj-dhjetor 2018, përgjatë çdo fundjave. 69% e pjesëmarrësve ishin nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë.^[39]

Instituti i Mjekësisë Ligjore. Gjatë vitit 2019, punonjësit e institucionit janë trajnuar në fushën e mjekësisë ligjore si të trajtojnë rastet e të miturve në konflikt me ligjin.

ekspertëve (oficerë policie) mbi të miturit dhe dhunën në familje, në strukturat e hetimit të krimit të të DVP-Durrës dhe gjashtë (oficerë policie) ekspertë të të miturve dhe dhunës në familje në strukturat e hetimit të krimit të të DVP-Tiranë; 2) një seancë trajnimi dy-javore me temë: "Trajnim mbi hetimin e krimeve penale me të mitur "me pjesëmarrjen e 23 oficerëve të policisë, ekspertë të hetimit të krimit (tetor 2019); 3) seminary mbi tema: "Qasja gjinore në hetimin e rasteve me të mitur, vendas dhe të huaj "me pjesëmarrjen e 18 oficerëve të policisë (dhjetor 2019); 4) janë mbajtur dy seminare tre-ditore me temë "Për hartimin e kurrikulës mbi teknikën e hetimit të të miturve " me pjesëmarrjen e ekspertëve suedezë dhe përfaqësues të Akademisë së Sigurisë dhe Policisë (shtator-tetor 2019) dhe përgatitja e kurrikulës në "Teknikat e hetimit për Njësinë e marrjes në pyetje" dhe trajnimi i ekspertëve të hetimit dhe psikologëve.

^[39] Trajnimi u organizua në dy module. Moduli i parë u ndoq nga 107 psikologë, që janë të angazhuar në proceset e drejtësisë për të mitur duke asistuar të miturit kur merren në pyetje/intervistohen. Ky modul ishte 50 orë dhe u fokusua në këto çështje 1. Njohuri ligjore mbi drejtësinë për të mitur në kontekstin shqiptar 2. Roli i psikologut që asiston të miturit gjatë marrjes në pyetje. 3. Çështje etike në proceset penale. 4. Zhvillimi psiko-social i fëmijëve 5. Teknikat e mbështetjes psiko-emocionale në proceset e drejtësisë për të mitur. Më 25 korrik, 2018, Urdhri i Psikologut përfundoi trajnimin me grupin e parë të psikologëve në fushën e drejtësisë për të mitur që u ndoq nga 54 psikologë të cilët pas këtij trajnimi thirren në cilësinë e psikologut asistues. Moduli i dytë u ndoq nga 80 psikologë vlerësues dhe çështjet ishin: 1. Konteksti ligjor i angazhimit të psikologut në proceset civile 2. Etika në proceset civile 3. Metodatat e vlerësimit në çështjet penale dhe civile me fëmijë. 4. Hartimi dhe paraqitja e raportit të vlerësimit.

Në kushtet e nevojës për një numër më të madh psikologësh të trajnuar që plotësojnë nevojat e të miturve siç janë asistencë dhe vlerësimi në komisarate policie, prokurori dhe gjykata në vend, në tetor 2018 Urdhri i Psikologut filloi një cikël të dytë trajnimesh me një grup të dytë psikologësh i cili përfundoi në 14 dhjetor 2018. Trajnimi i dytë u ndoq nga 51 psikologë, nga të cilët 16 nga Tirana dhe 35 nga qytete të tjera. Qëllimi i trajnimit të dytë ishte të rrisë numrin e psikologëve të trajnuar në përputhje me ligjin, sidomos në rrethet e tjera, për shkak të kërkesës në këto rrethet për këtë shërbim.





3. Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij raporti është rezultat i një procesi profesional, transparent dhe gjithëpërfshirës i ndërmarrë në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe politikat e kuadrin ligjor kombëtar. Procesi dhe përmbajtja e raportit është përpjekur të përfshijë të gjithë institucionet politikëbërëse, ministritë që lidhen me mbrojtjen e të miturve, agjencitë ligjzbatuese, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë përgjegjësi dhe njohuri në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe drejtësinë restauruese si dhe ndërmjetësimin.

Metodologjia dhe kërkimi për përgatitjen e Raportit Kombëtar ka konsistuar në:


- **Metodologji analitike** për rishikimin e literaturës mbi:
 - Kuadrin ligjor që përfshin drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Analiza e kuadrin ligjor kombëtar që rregullon drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për fëmijët e përfshirë në drejtësinë për të mitur si të akuzuar, si dëshmitarë dhe viktime dhe analizën e ligjeve dhe akteve nënligjore që ofrojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me një orientim tek fëmija viktimë;
- **Metodologjia historike** për rishikimin e literaturës mbi traditën shqiptare të zgjidhjes së konflikteve dhe pajtimit;
- **Metodologjia e analizës grafike** mbi procesimin e të dhënave nga:
 - Studime, raporte vjetore, dokumenta strategjikë, plane kombëtare veprimi, dokumenta politikë, projekte, marrëveshje bilaterale të Ministrisë së Drejtësisë, Parlamentit Shqiptar, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prokuroria e Përgjithshme, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Institucioni i të Miturve Kavajë, dhe projekte e programe si: UNICEF, Terre des hommes, Këshilli i Europës, SIDA, World Vision, Komiteti i Helsinkit, etc.
 - Burime statistikore nga Policia e Shtetit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj;
 - 113 pyetësorë të përshtatur për profesionistë të shpërndarë dhe të plotësuar gjatë aktiviteteve të mëposhtme dhe fokus grupeve.

- **Metodologjia sasiore dhe cilësore** në 11 aktivitete të organizuara me fokus grupe që përfshijnë një numër profesionistësh që punojnë në institucione të përfshira në drejtësinë për të mitur dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë si:
 - dy fokus grupe me 27 gjyqtarë të seksioneve për të mitur dhe atyre familjare;
 - një fokus grup me 22 prokurorë të seksioneve të drejtësisë për të mitur;
 - dy fokus grupe me 25 koordinatorë lokalë të bashkive përgjegjëse për mekanizmin e referimit të viktimave të dhunës dhe fëmijëve viktimë të dhunës;
 - dy fokus grupe me 12 oficerë policie nga prokuroria e rrethit dhe policia e shtetit;
 - një fokus grup me 9 ndërmjetës të ndarë në tre grupe;
 - një fokus grup me 7 profesionistë nga Shërbimi i Provës dhe 8 përfaqësues nga agjencitë e mbrojtjes së fëmijëve;
 - një fokus grup me 8 anëtarë të BKF;
 - një fokus grup me 5 fëmijë viktimë;
 - një intervistë individuale me një fëmijë viktimë;
 - një fokus grup me 8 anëtarë të BKF e organizuar në formën e një diskutimi pa pyetësorë;
 - një fokus grup me 5 fëmijë viktimë e organizuar në nivel lokal në Gjirokastrë. Ky fokus grup ka pyetësorë të specializuar për fëmijë që janë analizuar në mënyrë të veçantë nga pjesa tjetër e fokus grupeve.

Tabela dhe grafiku më poshtë tregojnë varietetin e pjesëmarrësve në fokus grupe po ashtu numrin e pjesëmarrësve për fokus grup.

- **Metodologjia cilësore** është përdorur për të analizuar intervistat individuale. Këto intervista janë zhvilluar me politikëbërës në nivel zëvendës/Ministër i Minsitrisë së Drejtësisë, me Drejtorin e Përgjithshëm të Politikës për Shëndetin dhe Mbrojtjen Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me drejtuesin e sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Gjinore në të njëjtën Ministri. Intervista janë realizuar po ashtu me përfaqësues të agjencive ligjzbatuese si: Drejtuesi i Policisë së Shtetit të Tiranës, Drejtuesi i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve, Kryetaren e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, një anëtar të këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Dhomës Penale në Gjykatën e Tiranës, Drejtuesin e Trajnimit fillestar dhe vijues në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Drejtuesit Ekzekutivë të tre OJF-ve; (Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, Qendra Shqiptare për Studime Ligjore dhe Trajnime (QSHSLT) dhe Qendra për Iniciativa Ligjore); intervista me tre avokatë, dy mësues nga shkollat e mesme në Tiranë “Cajupi” dhe “Partizani”, psikologë, punonjës socialë dhe fëmijë. Grafiku më sipër tregon kategoritë e ndryshme të personave të intervistuar.

Numri i intervistave





4. Gjetjet e kërkimit

Kërkimi ndoqi një strukturë me katër grupe kryesore:

- Politikëbërësit;
- Institucionet ligjzbatuese;
- Anëtarët e BKF;
- Fëmijët viktimë.

Pjesa vijuese e raportit do të analizojë në detaj, gjetjet në raport me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për këto grupe.

4.1 Politikëbërësit

Takimet dhe intervistat e zhvilluara me përfaqësues të lartë (zëvendës ministra) në Ministrinë e Drejtësisë, me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Shëndetin dhe Mbrojtjen Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Drejtuesen e Seksionit për të Mitur në të dy ministritë e përmendura tregojnë gjetjet e mëposhtme:

4.1.1 Objektivat e Politikës së Shtetit Shqiptar referuar dokumentacionit kryesor

Seksioni më poshtë ofron një përmbledhje të të gjithë dokumentave politike, dokumentave strategjike, udhëzuesve, agjendave kombëtare, planeve kombëtare të veprimit, etj. që tregojnë objektivat e Politikës së Shtetit lidhur me të miturit.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018–2021, e shoqëruar me Planin e Veprimit, është dokumenti i parë politik, që i përgjigjet kuadrit të ri ligjor dhe situatës aktuale në fushën e drejtësisë për të mitur. Strategjia ka pesë objektiva dhe ofron një qasje ndërdisiplinore, që do të integrohet në dokumenta të tjerë kombëtarë ekzistues, të shoqëruara me aktivitete konkrete. Strategjia ka pesë objektiva në nivel të lartë: (1) Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi; (2) Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit; (3) Parandalimi i ri-përfshirjes dhe recidivizmit në krime të të miturve; (4) Risocializim, riintegrim dhe rehabilitim i të miturve në kontakt me drejtësinë për të mitur (5) Rritje e kapaciteteve të strukturave të sistemit të drejtësisë për të mitur dhe bashkëpunimit midis tyre.

Pjesa dominuese e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit bazohen tek strategjia e drejtësisë për të mitur dhe përfshijnë masa që kanë në fokus fëmijët në situatë vulnerabël ose të disavantazhuar, për të cilët janë parashikuar linja të caktuara buxheti.

Rezoluta Parlamentare, e datës 28.3.2019, “Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” për vitin 2018 dhe për Planin e veprimit për vitin 2019,” thekson se një grup anëtarësh të parlamentit në bashkëpunim me grupet e tjera parlamentare do të ndjekin rekomandimet e Avokatit të Popullit, të Komisionierit për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit dhe Komisionierit për të Drejtën për Informacion dhe të Dhëna Personale lidhur me çështjet e të drejtave të

^[40] Në nëntor 2013, pas miratimit nga Parlamenti i Shqipërisë të rezolutës “Për mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” Grupi i Miqtë të Fëmijëve u formalizua si një grup ad hoc në Parlament. Miqtë e fëmijëve përbëhen nga 23 parlamentarë që angazhohen nga Anëtarët e parlamentit dhe synojnë të mbështesin një klimë të favorshme në Parlament për çështje që lidhen me fëmijët, përfshirë iniciativën e nismave ligjore që lidhen me të drejtat e fëmijëve, të sigurojnë llogaridhënie e zbatimin e tyre nga institucionet përgjegjëse.

fëmijëve, dhe do të zhvillojnë të paktën një dëgjese publike me ta në mënyrë që të forcohet roli i tyre dhe të garantohen të drejtat e fëmijëve.^[40]

Udhëzimi nr. 10/2015, “Mbi format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në risk për institucionet kyç dhe përgjegjësitë kryesore të tyre për mbrojtjen e fëmijëve” përkufizon rolin e secilit aktor në procesin e mbrojtjes së fëmijës dhe ofron udhëzimet e nevojshme në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në risk dhe kuadrin ligjor që i mbron ata.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 (AKDF)^[41] u miratua në 2017 dhe ka tre shtylla strategjike:

- (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve që synon forcimin e kuadrit rregullator dhe institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës për fëmijët;
- (iii) Sisteme dhe Shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët që janë Zhvillimi dhe Arsimit, Drejtësia, Shëndetësia dhe Ushqyerja, si dhe Mbrojtja sociale çka synon të identifikojë masat kryesore për strategjitë sektoriale që sjellin progres në zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Për këtë arsye, agjenda është shumë dhe ndër sektoriale, dhe përfshin të gjitha planet e tjera të veprimit që lidhen me fëmijët.^[42]

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020. Kjo strategji dhe ky plan veprimi ofrojnë një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe multisektoriale për dhunën me bazë gjinore dhe përmbajnë masa të ndryshme me ndikim direkt ose indirekt mbi parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës. Kjo strategji gjithashtu ofron masa për rehabilitimin e dhunuesit. Ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje është zgjeruar.^[43] Kur akomodohen në qendra, një plan shërbimi e integrimi hartohet për çdo fëmijë që përfshin mes të tjerash, përfshirjen dhe monitorimin e ndjekjes së shkollës. Më tej, aktivitete ndërgjegjësuere dhe argëtuese zhvillohen duke synuar zhvillimin e aftësive konjitive dhe sociale për ta. Punonjës socialë dhe psikologë të specializuar mbështesin nënat në qendër për tu bërë pjesë e skemave të punësimit dhe të strehimit, të cilat ofrohen nga organizatat jo-fitimprurëse, në mënyrë që të përmirësojnë situatën financiare të tyre. Të tjera shërbime të aksesueshme për viktimat, që ofrohen nga qendra publike dhe private, janë mes të tjerash, mbështetje psiko-sociale dhe strehim, referim në kujdes mjekësor, ndihmë ligjore, kurse formimi profesional dhe ndërmjetësim në punësim.^[44]

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 integron tre reforma madhore të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe synon të vendosë një sistem gjithëpërfshirës dhe të konsoliduar të mbrojtjes sociale për të luftuar pabarazinë socio-ekonomike dhe për të mbrojtur individët në nevojë.^[45]

^[41] Në nivelin politik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka miratuar dhe aktualisht është duke zbatuar dokumentin strategjik, **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020**. Ky është dokumenti i parë i hartuar duke u konsultuar me fëmijët. Vëmendje e veçantë në këtë dokument i kushtohet parandalimit si një strategji kryesore për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, duke promovuar prindërit pozitivë e jo të dhunshëm.

^[42] Në kushtet e politikave kryesore të drejtësisë penale dhe reformave që ekzistojnë në lidhje me dënimet alternative, drejtësisë dhe trajtimit restauruese, rehabilitimit, ose riintegrimi i të burgosurve në Shqipëri, vlen të përmendet Objektiv i 6 i Shtyllës së Drejtës Penale e Reformës në Drejtësi: Rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale. Objektiv i përgjithshëm i reformës së sistemit penitenciar është rritja e sigurisë publike dhe parandalimi i përgjithshëm e i posaçëm i kriminalitetit me anë të institutit të rehabilitimit, trajtimit human e me dinjitet dhe mbrojtjes së të drejtave të të dënuarve. Një objektiv tjetër që vlen të përmendet është objektiv i 8: Reformimi i sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedural. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve parashikon disa masa për mbrojtjen e fëmijëve në mjedis elektronik dhe dixhital. Këto janë pasqyruar më hollësisht në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, e nënshkruar në Shkurt 2016 nga ministritë kryesore: Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Brendshme, e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, e Arsimit dhe Sporteve, dhe veprimin pasues Planit 2018–2020 “Në një Internet më të Sigurt për Fëmijët”. Plani i veprimit përmban iniciativa të koordinuara nga sektor të ndryshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, ngacmimi dhe shfrytëzimi në internet. Sektori për Krimet Kibernetike, i krijuar që prej 2009 në Departamentin e Policisë Kriminale të Policisë së Shtetit (DPKPSH), ka vazhduar monitorimin ndaj materialeve abuzive për fëmijë, dhe identifikimin, hetimin e rasteve të përdoruesve shqiptarë ose të huaj të pamjeve ose imazheve pornografike të fëmijëve në internet. Në vitin 2015, si rezultat të bashkëpunimit ndërkombëtar me I akuzuaritetet e policisë gjermane dhe italiane, u ndërmorën dy operacionet policore ‘Pedofili’ dhe ‘Pedofili 2’ nga ku u arrestuan dy persona për veprën penale të ‘Pornografisë’ siç parashikohet në nenin 117 të Kodi Penal.

^[43] Një sistem regjistrimi operacional në internet që ka të dhëna statistikore mbi dhunën në familje në nivel lokal. Sistemi regjistron çdo rast dhune të identifikuar dhe adresuar nga mekanizmi lokal i referimit. Informacioni është kapur nga sistemi mbi keqëbërësit dhe viktimat, të ndara nga cenusshmëria, përkatësia etnike, gjinia, aftësia e kufizuar dhe statusi i punësimit. Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, e themeluar në 2011, ofron shërbime multidisiplinare 24-orëshe, duke përfshirë strehimin afatgjatë (më shumë se gjashtë muaj, ose më gjatë në rastin e një urdhri mbrojtjeje më të gjatë) për gra, vajza dhe djem deri në 16 vjeç. Numri i fëmijëve të akomoduar në vit është relativisht i qëndrueshëm, midis 38-59 raste në vit. Përveç qendrës kombëtare, gjashtë subjekte jopublike, të financuara nga buxheti i Shtetit, ofrojnë shërbime rezidenciale: dy në Tiranë dhe një në Berat, Korçë, Elbasan dhe Vlorë.



Dokumenti politik i strategjisë shqiptare për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve alkool-lidhura (2011-2015) përfshin ndërhyrje të ndryshme me fokus fëmijët, duke përfshirë masat informuese, edukuese (në shkollë dhe familje) masat fiskale dhe ligjore për të shmangur dhe minimizuar incidentet e lidhura me alkoolin midis fëmijëve dhe të rinjve, si dhe pasojat e këtij përdorimi. Në kuadër të **Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës 2012–2016, një seri aktivitete janë organizuar me qëllim parandalimin e përdorimit dhe abuzimit me substanca nga adoleshentët shqiptarë dhe të rinjtë, duke përfshirë edhe fushata ndërgjegjësuere të ndërmarrura në shkolla.**^[46]

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë fëmijët në situatë rruge (2019-2021) është hartuar me mbështetjen e OSBE. Strategjikisht PKV synon a) parandalimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve; b) mbrojtjen dhe shërbime/ndërrhyrjet e bazuara në nevojat e identifikuar të fëmijës; c) thyerja e barrierave sociale dhe kulturore që nxisin shfrytëzimin ekonomik; d) procedimi penal i rasteve të lidhura me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.

Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Personave 2018–2020 është e organizuar në katër shtylla strategjike: hetimi dhe procedimi penal, asistenca dhe mbrojtja e viktimave, parandalimi dhe koordinimi. Plan i ri i Veprimit ka llogaritur për herë të parë një buxhet për aktivitetet e tij. Mbrojtja e fëmijëve është forcuar me tej nga AKDF 2017–2020,

e cila përfshin masa për identifikimin proaktiv të viktimave potenciale të trafikimit në Shqipëri dhe ato jashtë vendit, po ashtu rikthimin vullnetar të tyre në Shqipëri.^[47]

4.1.2 Kuptimi i politikave në drejtësisë restauruese dhe masat për lehtësimin e procesit të drejtësisë për të miturit

Qeveria Shqiptare dhe institucione të tjera në përgjithësi kanë një të kuptuar të mirë të politikave të Drejtësisë Restauruese dhe shërbimeve të ndërmjetësimit. Masat për lehtësimin e procesit të drejtësisë për të mitur janë si më poshtë:

A. Aplikimi i praktikave të mira që lidhen me shërbimin e ndërmjetësimit dhe rolin e ndërmjetësit

Në Shqipëri, ka disa praktika të mira që lidhen me ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese:

- Statusi ligjor i ndërmjetësit ka treguar se ka funksionuar mirë, specifikisht për faktin se ndërmjetësi është një profesion i lirë dhe i licencuar ashtu si avokati dhe noteri.
- Krijimi dhe funksionimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN) përmbush qëllimin e ndjekjes dhe monitorimit të specializimit dhe profesionalizmit të ndërmjetësve.
- Krijimi i sistemit kombëtar të regjistrimit të ndërmjetësve në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë lehtëson njohjen dhe promovimin e

^[44] Në bashkëpunim me UNDP, qendrat e urgjencës për gra dhe vajza të cilat janë viktime të dhunës në familje që kanë nevojë për strehim të përkohshëm janë hapur në katër qytete: Pogradec, Sarandë, Përmet dhe Roskovec. Një kornizë rregullatore është duke u hartuar duke synuar përcaktimin e standardeve të shërbimeve që do të ofrohen nga objektet e urgjencës bashkiake për viktimat e dhunës në familje në bazë të gjinisë, përfshirë të mbijetuarit e ngacmimeve seksuale dhe dhunës seksuale. Që nga shkurti 2017, Linja Kombëtare e Këshillimit për Viktimat e Dhunës në Familje filloi funksionimin duke siguruar mbështetje falas 24-orëshe nga psikologë, avokatë dhe profesionistë të tjerë.

^[45] Strategjia parashikon transformimin e ndihmës ekonomike në një skemë aktive të riintegritit social, rishikimn e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, ndërhyrjet dhe riintegrimin e fëmijëve në familje dhe komunitete duke ju siguruar kujdes të veçantë për fëmijët jetim socialë ose biologjikë, duke i dhënë përparësi më të madhe interesit më të lartë të fëmijës dhe sigurimin e shërbimeve të integruara. Janë miratuar disa strategji të tjera dhe planet e veprimit në fusha si, strehimi social, shëndeti seksual dhe riprodhues, lufta kundër trafikimit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, dhe integrimi i romëve e egjiptianëve, me qëllim rritjen e zbatimit të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

^[46] Mesatarisht, 18,000 nxënës njihen çdo vit me programin në më shumë se 300 shkolla pjesëmarrëse. Qendra e Kontrollit Kombëtar të Barnave në vijim, i ka kushtuar vëmendje përmirësimit të sistemit të trajtimit antidrogë, duke përfshirë zhvillimin e trajnimit të familjes dhe të kujdesit shëndetësor në konceptet themelore të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe referimit të rasteve, krijimn e pajisjeve të specializuara për trajtimin e ilaçeve dhe ekipe multidisciplinare në gjashtë spitalet rajonale të vendit, si dhe përfshirja në skemat e sigurimeve të ilaçeve të lidhura me varësinë. Këto masa do të sjellin kapacitetet të pamjaftueshëm të trajtimit dhe një kërkesë në rritje për trajtim (aktualisht llogariten 8,000 dhe 10,000 përdorues problematikë të drogës të të gjitha moshave). Aktualisht, ka vetëm një qendër publike të shërbimit të varësisë e specializuar në terapinë e varësisë, mesatarisht me 800–900 pacientë që vizitojnë klinikat në vit.

^[47] Në vitin 2018, është miratuar një PSV për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, duke forcuar ekzistencën e mirë-koordinuar dhe gjithëpërfshirëse të identifikimit, referimit dhe sistemit të mbrojtjes. Procedura përfshin fëmijët, qofshin shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, nga çdo shfrytëzim kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo, së bashku me kapacitetet e zgjeruara të autoriteteve përkatëse dhe palët e interesuara (përfshirë OJQ-të), ka kontribuar në përmirësimin e identifikimit të viktimave, ka forcuar bashkëpunimin midis strukturave përkatëse dhe ka parashikuar përgjigje në më pak kohë dhe më të saktë ndaj krimeve të tilla. Qeveria mbështet një Qendër publike për gratë dhe fëmijët viktime të trafikimit dhe tre qendra populike të trajtimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Një nga këto qendra strehimi të drejtuara nga OJQ ofron shërbime të specializuara për viktime me moshë më të vogël se 18 vjeç. Të katër qendrat e strehimit përbëjnë Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik, duke ofruar shërbime

- ndërmjetësve në gjykata dhe prokurori në rastet e shmangies së hetimit penal të për të mitur.
- Duke ndjekur udhëzimet e Minsitrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, ka planifikuar specializimin e ndërmjetësve bazuar në forma të ndryshme të konflikteve. Ata ofrojnë specializim dhe trajnim të vazhdueshëm që ka kontribuar në profesionalizmin e ndërmjetësve. Pas miratimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka organizuar trajnime të tilla. Një grup prej 9 ndërmjetësish është trajnuar në mënyrë specifike për rastet e të miturve. Lista e këtij grupi është depozituar në Ministrinë e Drejtësisë.^[48] Grupi i ndërmjetësve është çertifikuar për të zbatuar zgjidhje alternative për të miturit në konflikt me ligjin. Kështu, deri në 2020, ka patur vetëm një rast të shmangies për një të mitur në konflikt me ligjin. Në atë rast, pala ishte detyruar të kompensonte vlerën e dëmit palës së dëmtuar. Numri i rasteve aktualisht është shumë i kufizuar për shkak të situatës së Covid-19 situation dhe efekteve që ai ka patur në sistemin e drejtësisë.
 - Ministria e Drejtësisë ka mbështetur DHKN në arritjen e marrëveshjeve me Shërbimin e Provës, Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës. (NJMF).
 - DHKN bën pjesë në strategjinë e inicjuar nga MD për të gjithë mekanizmin e drejtësisë për të mitur.


B. Krijimi i hapësirave të veçanta për të lehtësuar drejtësinë miqësore për fëmijët dhe aplikimin e masave të shmangies

Para prezantimit të KDM, një nga detyrimet e Qeverisë Shqiptare ishte dhe vazhdon të jetë krijimi i njësive dhe hapësirave/dhomave të veçanta për intervistimin dhe komunikimin me fëmijët e përfshirë në procesin e drejtësisë për të mitur. Këto hapësira përdoren për të kryer procedurat e shmangies, përfshirë drejtësinë restauruese dhe programet e ndërmjetësimit, si dhe sesione të natyrës edukative, rehabilituese dhe restauruese. Në linjë me këto masa, udhëzimet janë përgatitur për çdo institucion dhe agjenci ligjzbatuese. Këto njësi dhe hapësira janë krijuar në vendet e mëposhtme:

- **Gjykata.** Aktualisht, në gjykatat në vijim janë krijuar hapësira miqësore për fëmijët: Gjykata

e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Gjykata e Rrethit Lushnje.^[49]

- **Zyrat e Prokurorisë.** Në 2019, janë krijuar dhoma për fëmijët në zyrat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit të Elbasanit, Shkodrës, Durrësit, Fierit, Korçës, Beratit dhe Tiranës. Këto institucione kanë tashmë hapësira miqësore të përshtatshme për të miturit.
 - **Policia e Shtetit.** Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, u hartua dhe miratua nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Procedura Standarte e veprimit për “Njësinë e intervistimit të të miturve, standartet teknike dhe procedurat e përdorimit të këtyre hapësirave”, së bashku me **Urdhri Nr.715, 05.06.2019**^[50]
 - **Njësia për Intervistimin dhe Komunikimin me të miturit** është ngritur në: departamentin e policisë Lezhë dhe komisariatit të policisë Kurbin, me mbështetjen e World Vision, dhe në departamentin e policisë në Elbasan me mbështetjen e Programit Suedez për Policinë në Komunitet. Dy njësi të tjera të Intervistimit të të Miturve kanë filluar të ngrihen në departamentet e policisë Berat dhe Gjirokastrë, me mbështetjen e UNICEF.
- Më poshtë gjenden disa foto nga Rajoni i Policisë Nr. 6 në Tiranë ku një hapësirë miqësore për fëmijët është krijuar me ndihmën e World Vision.



→ **Shërbimi i Provës.** Janë përshtatur dhjetë hapësira në qendrat komunitare për zbatimin e masave të shmangies. Përgjatë 2019, Shërbimi i Provës ka trajtuar 6 të mitur në rastet kur është dhënë masa e shmangies. Ndër ta, tre të mitur janë trajtuar në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) dhe qendrat sociale në bashkitë Tiranë, Lezhë dhe Shkodër. Në Shkodër, Lezhë, Lushnje, Vlorë, Sarandë, Korçë, Përmet dhe Elbasan janë përshtatur tetë njësi lokale të Shërbimit të Provës. Zyrat janë marrë me qira dhe asnjë buxhet specifik nuk është krijuar apo shpenzuar për hapësirat e fëmijëve. Duke marrë në konsideratë numrin e strukturave organizative/ punonjësve të Shërbimit të Provës që trajtojnë çështjet me të miturit, rezulton se nuk ka patur rritje të numrit. Aktualisht, janë 25 punonjës të trajnuar që mbulojnë këto çështje.

→ **Avokati i Popullit.** Bazuar në Strategjinë dhe Planin e Punës 2019-2022 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, është ngritur dhe vijon punën Sektori i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e Avokatit të Popullit, ku një nga objektivat e tij më kryesore është promovimi i drejtësisë miqësore për fëmijët. Është krijuar një rrjet me funksion ndër-institucional për drejtësinë për të miturit, i cili në 2018 përfshinte 30 përfaqësues. Në 2019, pritej të kishte përfaqësim 10% më të lartë se në 2018 dhe për 2020 dhe 2021 plani është për të patur 10% më

shumë institucione, që operojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në të njëjtën kohë, dhjetë grupe komunitare janë formuar në nivel lokal tashmë. Këto grupe janë të përbëra nga praktikantë të punës sociale e psikologjisë, mësues, prindër etj.

C. Masat për rritjen e ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe aplikimi i drejtësisë miqësore për fëmijët

Parlamenti Shqiptar miratoi Vendimin Nr. 47/2019 **“Për miratimin e strategjisë për edukimin ligjor të publikut.”** Sipas këtij vendimi, aktorët institucionalë kanë një rol të madh në rritjen e ndërgjegjësimit publik ndaj Drejtësisë Restrauruese (DR) dhe ndërmjetësimit, si dhe në mbrojtjen e fëmijëve.

Ministria e Drejtësisë (MD). Në MD veprojnë dy qendra të informimit ligjor: Qendra e Viktimës dhe Klinika e Ligjit. E dyta synon të kryejë funksione si: orientimi i qytetarëve për të identifikuar problemin saktë dhe për ta adresuar atë tek institucioni i duhur; ndihmesa në hartimin e letrave dhe kërkesave; sigurimi i informacionit parësor mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve; ofrimi i këshillimit ligjor mbi ndihmën ligjore falas dhe zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim, etj. Qendra e Viktimës synon ofrimin e ndihmës për viktimat, përkujdesjen për shëndetin e tyre dhe rehabilitimin mjekësor, asistencë psikologjike, ndërgjegjësim mbi ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese etj.

plotësuese për viktimat e trafikuar. Individët në qendrat / strehimoret marrin një paketë ndihme të përbërë nga ushqim, këshillimi, ndihma juridike, kujdesi mjekësor, mundësi arsimimi, libra shkollorë për fëmijë viktime, shërbime punësimi, ndihmë për fëmijët e viktimave, mbështetje financiare, akomodim afatgjatë, aktivitete sociale, trajnim profesional, dhe kujdesin shëndetësor falas. Gjatë periudhës 2012–2018, 198 viktime të trafikimit ose viktime të mundshme të trafikimit ishin akomoduar në Qendrën Kombëtare dhe 398 në tre qendra të tjera. Viktimat e huaja të trafikimit kanë akses në të njëjtat shërbime në Shqipëri siç kanë ato vendase, ndërsa ligji u jep viktimave të huaja një refleksim tre-mujor, periudhë kjo me status qëndrimi të përkohshëm dhe autorizim për të punuar deri në dy vjet.

^[48] Janë organizuar katër sesione treditore në fusha të ndryshme që lidhen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe mekanizmit të referimit në Dhjetor 2018 me Save the Children si donator; në shkurt 2019 në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për Zgjidhjen e Konfliktëve, me Terre des hommes si donator; në korrik 2019 Qendra Berlin për Ndërmjetësimin Integruar, DHKN, FZK dhe gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor AFCR trajnim i vazhduar nga DHKN.

^[49] Gjatë 2019, projekti i USAID “Drejtësi për të Gjithë” shpalli përdorimin e projektit në Gjykatën e Rrethit Tiranë për krijimin e një hapësire miqësore për të miturit në sektorin penal. Gjatë 2020, janë dhënë fonde për të përshtatur hapësira të tilla në pesë gjykata të tjera që kanë hapësira fizike të përshtatshme dhe të cilat mund të përshtaten në hartën e gjykatave të reja. Këto pesë gjykata janë: Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Rrethit Dibër, Gjykata e Rrethit Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Shkodër.

^[50] Është krijuar një grup pune me ekspertë nga Sektori i Dhunës në Familje dhe tek Fëmijët si dhe ekspertë në strukturat e kimit të organizuar të Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit-Tiranë dhe anëtarët e tij kanë bashkëpunuar ngushtë me Autoritetin Policor Suedez në kontekstin e një programi tre vjeçar 2017-2020 “Forcimi i kapaciteteve të agjencive Shqiptare të zbatimit të ligjit për të përmbytur standartet e të drejtave njerëzore me drejtësinë për fëmijë – një qasje e përgjithshme e zinxhirit të drejtësisë” (SIDA) në mënyrë që të merret ekspertiza më e mirë suedeze dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Dy struktura policore kanë ndërtuar hapësira për krijimin e Njesive për Intervistimin dhe Komunikimin me Fëmijët dhe kanë filluar gjithashtu përgatitjet për projektet e përshtatjes dhe ristrukturimit. Këto struktura policore janë DVP – Tiranë, Komisarjati i Policisë Nr.3, dhe DVP – Durrës. Sipas një përlogaritjeje fillestare, kostoja e përafërt e përshtatjes/ristrukturimit, mobilimi, blerja dhe instalimi i pajisjeve teknike të regjistrimit audio-video për Njesinë për Intervistimin dhe Komunikimin me Fëmijët është rreth 25,000 euro pa TVSH. Aktivitetet e lartpërmendura janë planifikuar dhe do të mbahen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e Autoritetit Policor Suedez në kontekstin e programit tre vjeçar SIDA.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e trajnimeve edukuese të vazhdueshme për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistë të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje. Agjencia koordinon gjithashtu dhe organizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për të promovuar mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha fushat.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është përgjegjëse për organizimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe informuese me qëllim parandalimin e akteve kriminale. Ajo ka për detyrë të rrisë bashkëpunimin me publikun. Ndër të tjera, bazuar në legjislacionin mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Edukimin, Ministrinë përgjegjëse për Shëndetin dhe Ministrinë përgjegjëse për Punët Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë duhet të marrë masa drejt parandalimit të përfshirjes së fëmijëve në aktivitete kriminale.



Njesitë e Qeverisjes Vendore janë përgjegjëse për informimin e publikut në çdo bashki dhe për krijimin e vënien në punë të mekanizmave koordinuese për referimin e rasteve të dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve. Për ta arritur këtë, ata duhet të ofrojnë shërbime me materiale apo publikime ndërgjegjësuere mbi dhunën dhe viktimat e saj.

DHKN i ofron publikut informacionin e nevojshëm mbi aktivitetet e ndërmjetësve në zgjidhjen e konflikteve dhe mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve.

Avokati i Popullit. Në linjë me detyrat e institucionit të AP, ky institucion promovon dhe mbron të drejtat e njeriut dhe parandalon shkeljen e tyre, duke përfshirë këtu të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, të viktimit apo të dëshmitarit. Gjatë 2019, Avokati i Popullit

nënshkroi një marrëveshje me UNICEF për të monitoruar veprimet dhe mos-veprimet e institucioneve që menaxhojnë drejtësinë penale për fëmijët, me fokus të veçantë tek: (a) Promovimi dhe monitorimi i të drejtave të fëmijëve nga institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor; (b) Vlerësimi i aplikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të adresuara në raportin “Me zërin e të miturve të privuar nga liria,” që synon monitorimin e kushteve dhe trajtimit nga institucionet e heqjes së lirisë dhe në kontekstin e drejtësisë penale për fëmijët; (c) Iniciativa e promovimit dhe zbatimit të **Ligjit Nr. Nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur”** në praktikë në disa nga institucionet që trajtojnë fëmijët në konflikt me ligjin, të cilëve u është hequr liria.

Departamenti i Ndhmës Ligjore Falas dhe institucione të tjera përgjegjëse kanë si qëllim organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere lidhur me të drejtat e fëmijëve, qofshin ata akuzuarë, viktimat apo dëshmitarë dhe mbi shërbimet nga të cilat fëmijët përfitojnë. Departamenti e mundëson këtë përmes garantimit të së drejtës së fëmijëve për informacion dhe ndihmë ligjore duke përfshirë në kurrikulën e shkollës module të edukimit ligjor. Qëllimi i parësor është ndërgjegjësimi i publikut mbi zbatimin e ligjit “Mbi ndihmën ligjore të garantuar nga Shteti.” Këto aktivitete ndërgjegjësuere publike do të mbahen përgjatë 2020.

Detyra e institucioneve të mësipërme është, për rrjedhojë, të familjarizojë publikun me alternativat e zgjidhjes së konfliktit, të orientojë aktorët, përfshirë fëmijët, larg vetë-gjyqësisë dhe hakmarrjes, me qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të paligjshme, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi përparësitë e ndërmjetësimit përmes organizimit të fushatave të edukimit në masë për publikun.

4.1.3 Programe për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin

Gjatë vitit 2019, Ministria e Drejtësisë vazhdoi koordinimin e aktiviteteve në fushën e drejtësisë penale me disa organizata ndërkombëtare.

Strategjia e Ministrisë së Drejtësisë ka parashikuar zbatimin e dy programeve për: i) drejtësinë restauruese dhe ii) ndërmjetësimin për fëmijën dhe viktimën. Tabela në vijim tregon objektivat e synuar dhe të raportuar.^[51]

Tregues	Zbatimi i dy programeve për: i) drejtësinë restauruese dhe ii) ndërmjetësimin për fëmijën dhe viktimën.				
Institucioni përgjegjës	Ministria e Drejtësisë				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera e synuar	-	20% e fëmijëve kanë përfituar nga programet	50% rritje nga 2019 e fëmijëve që kanë përfituar nga programet	80% rritje nga 2020 e fëmijëve që kanë përfituar nga programet	
Objektiv i raportuar për 2019	Programet lidhur me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për fëmijët dhe viktimat zbatuar në bashkëpunim me Terre des hommes.				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera e synuar	-	25% e fëmijëve kanë përfituar nga programet	50% rritje nga 2019 e fëmijëve që kanë përfituar nga programet	80% rritje nga 2020 e fëmijëve që kanë përfituar nga programet	
Objektiv i raportuar për 2019	Program i këshillimit dhe ndërgjegjësimin publik për fëmijët zbatuar nga Terre des hommes bashkë me FZK. Objekivi është arritur.				

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) punon me statistikat lidhur me zbatimin e drejtësisë restauruese dhe programeve të ndërmjetësimin. Në **nenin 38 gërma “h” e Ligjit Nr. 37/2016 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”** parashikohet se: “Prokuroria e Përgjithshme dërgon të dhënat statistikore mbi çështjet penale tek MD në mënyrë që të hartohen statistikat e përbashkëta në fushën e drejtësisë.” Të dhënat statistikore të marra nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm tregojnë se në 2019, Zyrat e Prokurorisë të Rretheve kanë vendosur mbylljen e 19 çështjeve dhe aplikimin e masës së ndërmjetësimin.

75 punonjës të Shërbimit të Provës janë kualifikuar për drejtësinë restauruese për fëmijë dhe janë të aftë të bashkëpunojnë me ndërmjetësit, të cilët monitorojnë marrëdhëniet viktimë-i akuzuar.^[51] Kualifikimi është ndërmarrë nga UNICEF, i cili ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Save the Children mbi zbatimin e drejtësisë restauruese dhe programet e ndërmjetësimin në këshillimin e prindërve dhe

fëmijëve, në zbatimin praktik të masave të shmangies dhe ndëshkimin alternativ për riintegrimin socio-ekonomik të fëmijëve. Ky program do të vihet në zbatim në 18 muaj në vijim në Berat dhe Gjirokastrë.

Terre des hommes, në bashkëpunim me FZK, është në procesin e hartimit të udhëzuesit për avokatët dhe të një programi trajnimit. Hartimi i kurrikulës në trajnimin e vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët mbi masat e shmangies është përfunduar dhe është përfshirë në kurrikulën e Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020. Trajnimi për rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të shoqërisë civile mbi qasjen e drejtësisë restauruese është përfunduar.

Për më tepër, procesi i hartimit të modelit të riintegrimin të fëmijëve në konflikt me ligjin është përmbytur. Në këto kushte, Terre des hommes ka trajtuar 20-22 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin të referuar nga Shërbimi i Provës, Policia, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe zyra e prokurorit, prej të cilave 5 janë

[51] Sipas të dhënave nga Raporti i përgatitur nga MD mbi rezultatet e zbatimit të Strategjisë 2019, vërehet se qëllimi i MD për 2019 është arritur. Për 2020, ende janë duke u mbledhur të dhënat dhe do të raportohen në 2021.

[52] UNICEF ka përditësuar “Manual i Drejtësisë Restauruese për Punonjësit e Shërbimit të Provës dhe bashkëpunimi i tyre me Ndërmjetësit” (hartuar nga UNICEF disa vite më parë) duke reflektuar mbi standartet e kërkuara nga Kodi Penal për të Mitur. Në të njëjtën kohë, dhe si pjesë e Manualit, UNICEF ka mbështetur Departamentin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës në hartimin e një udhëzuesi për Monitorimin e Marrëdhënieve Viktimë-I akuzuar

drejtuar tek punësimi dhe/ose formimi profesional. Sa më sipër, protokollet e punës me fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin janë hartuar dhe përfunduar. Dhjetë organizata lokale janë financuar gjithashtu për të zbatuar projekte afatshkurtra në krijimin dhe zbatimin e programeve/modeleve bazuar tek parimet e drejtësisë restauruese. Projektet janë duke u zbatuar në Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Dy takime të tjera do të mbahen për krijimin e një rrjeti pune në fushën e DR; takime online për të diskutuar dhe trajtuar çështjet e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin; si dhe mbajtja e një trajnimit mbështetës për ndërmjetësit në nivel kombëtar.

Programi Shqiptaro-Suedez për drejtësinë penale për fëmijët ka ndihmuar gjithashtu në drejtësinë për fëmijët duke ofruar ekspertizë në zhvillimin e materialeve informuese mbi shmangien për të miturit.

4.1.4 Programe dhe projekte të fokusuar te drejtësia miqësore për fëmijët

Gjatë 2019, **UNICEF Albania** përfundoi përkthimin në shqip të "Udhëzuesi i Ofrimit të Ndhmës Ligjore për Drejtësinë Miqësore për të Miturit," i cili i është vënë në dispozicion Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në të njëjtin vit, UNICEF ka vënë në dispozicion të Gjykatave të Rrethit Berat dhe Gjirokastrë, përmes bashkëpunimit me Save the Children, 2 avokatë të cilët ofrojnë ndihmë ligjore parësore dhe dytësore për fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin. Kjo do të vijojë edhe në 2020 dhe ka si qëllim përmirësimin e kontekstit profesional të ndihmës ligjore në dy forma: parësore dhe dytësore. UNICEF Albania është angazhuar të krijojë dy hapësira miqësore për fëmijët në komisarariatet e policisë në Berat dhe Gjirokastrë, ku do të kryhen intervistat me fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin.

Në bashkëpunim me Save the Children, UNICEF ka trajnuar gjithashtu 32 ekspertë nga disiplina të ndryshme të Gjykatës së Rrethit Berat dhe Gjirokastrë mbi bashkëpunimin ndër-insitucional mbi çështjet për fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin. Këta ekspertë do të mbështeten me ndihmë teknike gjatë 2020.

UNICEF ka mbështetur po ashtu Urdhrin e Psikologut për të hartuar një seri broshurash informuese për gjykatësit dhe prokurorët lidhur me rolin e psikologut në çështjet penale, civile apo familjare kur ka fëmijë të përfshirë. Dy nga broshurat i dedikohen prokurorëve

dhe gjykatësve si një guidë mbi rolet e ndryshme që mund të kenë psikologët në procesin penal me fëmijët. Broshura e tretë i dedikohet gjykatësve të sektorit familjar, kryesisht në vendime kujdestarie. Broshura e katërt i dedikohet gjykatësve, të cilët kërkojnë vlerësim psikologjik në rastet kur fëmijët që janë prekur nga krimi, aksidentet etj dhe kërkojnë kompensim të dëmit nga gjykata.

UNICEF gjithashtu ka mbështetur MD për të krijuar një prototip të Sistemit të Integritit të të Dhënave për Drejtësinë Penale për Fëmijë, e cila do të realizohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Përpos hartimit dhe zhvillimit të konsultimeve mbi aktet nën-ligjore të KDM, UNICEF ka mbështetur publikimin e një përmbledhjeje që liston strukturat normative të drejtësisë penale duke përfshirë Kodin e Drejtësisë Penale për Fëmijë në Shqipëri (në shqip dhe anglisht) dhe të gjitha aktet nën-ligjore të miratuara në 2018 dhe 2019 në raport me zbatimin e tij.

World Vision është në procesin e krijimit të një hapësire miqësore për fëmijët në rajonin e policisë Lezhë. Marrëveshja është nënshkruar në 17 maj 2019. World Vision ka përfunduar 4 hapësira miqësore funksionale për intervistimin e fëmijëve në Tiranë (Rajoni i policisë Nr.6), Kamëz (Rajoni i policisë Nr.5), Lezhë dhe Kurbin. Në tetor 2019, u mbajt inaugurimi i hapësirës së re në Kurbin. Që prej tetorit 2019, një ekip i përbërë nga një punonjës social dhe një psikolog nga World Vision ofrojnë mbështetje psiko-sociale gjatë intervistimit në rajonet e policisë Lezhë dhe Kurbin.

Për sa i përket rritjes së kapaciteteve të ekspertëve të specializuar në sistemin e drejtësisë për të mitur, World Vision ka hartuar termat e referencës për krijimin e një moduli trajnimit dhe ka organizuar një trajnim për 160 ekspertë të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë këtu punonjës policie, si pjesë të grupeve teknike ndër-sektoriale. Trajnimi është mbajtur në shtator 2019 për ekspertët e mbrojtjes së fëmijëve për 24 bashki.

Programi Shqiptaro-Suedez për drejtësinë penale për fëmijë ka ofruar ekspertizë në rishikimin e rregullave të brendshme të Institutit për të Mitur në Kavajë; ekspertizë për hartimin e akteve nën-ligjore të reja dhe/ose rishikimet/shtesat në legjislacion për sa i përket drejtësisë penale për fëmijë. Ata kanë realizuar dhe një seminar në lidhje me përmirësimin e kushteve për një strukturë më të mirë organizacionale të sistemit

të drejtësisë për fëmijë në mënyrë që të vlerësohen risqet dhe nevojat. Seminari u fokusua gjithashtu tek planifikimi i instrumenteve për ndëshkimin dhe përgatitjen e modeleve për mos-konformimin me detyrimet, po ashtu për përmbushjen e detyrimeve. Për sa i përket rritjes së profesionalizmit në institucionet ligj-zbatuese kur trajtojnë çështje me të miturit, programi hartoi një kurrikulë për: (*) Teknikat e Intervistimit Shkencor të Njësive Intervistuese; (*) Trajnim për zbatimin e KDM; Trajnim për Raportin e Vlerësimit Individual.

Komiteti Holandez i Helsinkit (NHC), në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, synojnë të kontribuojnë në reformimin e sistemit të burgjeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut duke përmirësuar mundësitë e të miturve të burgosur për tu riintegruar në shoqëri me sukses. Kjo do të bëhet përmes prezantimit të metodave zyrtare të punës për stafin e burgjeve, si dhe integrimin e tyre në politika zyrtare dhe kurrikulën e institucioneve edukuese, e po ashtu duke forcuar kapacitetet e stafit të burgjeve dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky projekt ka trajnuar ekspertë nga organizata të shoqërisë civile të cilët, për një periudhë prove 1 vjeçare, si dhe do të ofrohen aktivitete artistike dhe sportive përmes "Kontributit Pozitiv për Shoqërinë". Përfituesit direktë do jenë të miturit që janë të paraburgosur/dënuar në Institutin e të Miturve Kavajë. Me ekspertë nga Universiteti Leiden, dhe falë metodës së Instrumenteve të Klimës Sociale, është mundësuar matja e treguesve të klimës së punës për stafin e

institucioneve, si dhe atmosfera e jetesës dhe edukimit për të miturit në Institutin për të Mitur, Kavajë.


4.2 Institucionet dhe agjencitë ligj-zbatuese

4.2.1 Praktika kombëtare dhe jurisprudenca në drejtësinë për fëmijët, drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm. Me **Urdhrin Nr.114, datë 09.07.2019**, Prokuroria e Përgjithshme krijoi Qendrën e Zhvillimit për Drejtësinë Penale për të Mitur duke marrë në konsideratë nevojat për unifikimin e praktikave për zbatimin e Kodit për Drejtësinë Penale për të Mitur dhe për të kuptuar praktikat më të mira të punës kombëtare dhe ndërkombëtare. Qendra ka si qëllim hartimin e dokumentacioneve, politikave, udhëzuesve, manualeve, shpërndarjen e praktikave më të mira, mbështetjen dhe këshillimin e prokurorëve. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të kandiduar në këtë qendër do të punojnë me kohë të pjesshme në këtë Qendër.

Statistikat dhe të dhënat e marra nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë bashkangjitur atyre të Gjykatave të Rretheve tregojnë se gjatë 2019 ka patur 194 fëmijë të përfshirë në ndjekjen e drejtësisë për të mitur. Numri i fëmijëve të përfshirë në procedimet penale ishte më i lartë krahasuar me 2018, (27). Në raport me moshën e fëmijëve: dy fëmijë ishin nën 14

Numri i rasteve të të miturve -Prokuroria e Tiranës




vjeç, 49 fëmijë ishin të grupmoshës 14 deri 16 vjeç dhe të grupmoshës 16 deri 18 vjeç, ishin 89 fëmijë.

Në grafikun në vijim, mund të shikohet numri i rasteve të regjistruara në drejtësinë për të mitur dhe numrin e rasteve, tek të cilët është përdorur masa e shmangies, duke përfshirë drejtësinë restauruese, si dhe numrin e rasteve që janë dërguar në Gjykatë për vazhdimin e procedimit penal, pasi masa e shmangies nuk mund të përdorej.

Kolonat e kuqe tregojnë numrin e rasteve dhe kolonat vjollcë tregojnë numrin e fëmijëve të përfshirë në drejtësinë penale. Në vitin 2019, ka patur 247 fëmijë të përfshirë në 194 raste. Vihet re se numri i rasteve ku është aplikuar masa e shmangies është më i lartë në vitin 2019 (52) krahasuar me numrin e rasteve që janë dërguar në Gjykatë (36).

Statistika të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës




	2018	2019
Totall	1897	2449
Raste të reja	997	1078
Raste të zgjidhura	615	566

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë. Statistikat e marra nga intervistat me Drejtorin e Drejtorisë së Policisë Tiranë tregojnë se gjatë vitit 2017, (një vit përpara miratimit të Kodit për Drejtësinë për të Mitur) numri i fëmijëve që kanë kryer krime dhe shkelje ishte 2,053 dhe numri i viktimave fëmijë ishte 1,340. Viktimat fëmijë janë përballur si me të akuzuarë fëmijë, ashtu edhe me të akuzuarë të rritur.

Përgjatë vitit 2018 ka patur rritje të numrit të të akuzuarve fëmijë në 2,247 dhe një rënie të ulët të numrit të fëmijëve viktimë në 1,248. Në vitin 2019, numri ishte më i ulët për të dyja ndryshoret. Më konkretisht, ka patur 1,996 të akuzuar fëmijë dhe 1,228 viktimë fëmijë. Sidoqoftë, numri i fëmijëve viktimë është ende i lartë, 100 fëmijë të lënduar në muaj.

Punonjësit e institucioneve shëndetësore ose të kujdesit për fëmijë, publike apo private, janë të detyruar të raportojnë menjëherë tek drejtori i institucionit, Policia e Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës, çdo rast të dyshuar apo ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit,

Statistika të Policisë së Shtetit mbi numrin e fëmijëve të përfshirë në drejtësinë për të mitur



	2017	2018	2019
Fëmijë autorë	2053	2247	1996
Fëmijë viktimë	1340	1248	1228

braktisjes, neglizhimit apo dhunës ndaj fëmijëve. Të dhënat e raportuara tregojnë se policia ka raportuar numrin më të lartë të rasteve, 128, ose 12% të totalit, ndjekur nga 107 raste të raportuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë bazuar tek kërkesat e Ligjit mbi Ndihmën Ligjore, por gjithashtu në Ligjin apo Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim me Këshillin e Europës, përmes programit online HELP. Avokatët nga e gjithë Shqipëria janë trajnuar për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Gjatë vitit 2019, sesionet e trajnimit janë mbajtur për të përmirësuar njohuritë për avokatët kryesisht dhe avokatë të tjerë që japin ndihmën e tyre ligjore në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë dhe mbështetjen e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka njësi në nivel lokal. Në përputhje me **nenin 67 të Ligjit 18/2017 "Detyrim për raportim"**, çdo punonjës i institucioneve publike apo private në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit të tyre dhe që dyshojnë ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijë. Menjëherë pas marrjes së informacionit mbi nevojën e mbrojtjes së fëmijëve, njesia arsimore vendore, në çdo rast, raporton tek strukturat për mbrojtjen e fëmijëve.

Shumë raste që përfshijnë raste të fëmijëve në konflikte, veçanërisht ato ku fëmijët janë viktimat e sjelljeve kriminale të kryera nga të rriturit apo fëmijë të tjerë, janë raportuar vazhdimisht tek agjencitë vendore të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve të ndodhura në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Rastet e keqtrajtimit janë raportuar nga mësues, psikologë, prindër, oficerë policie apo nga vetë fëmijët. Gjatë vitit 2018, numri i rasteve arriti në 1,897 në total, përfshirë këtu raste të pazgjidhura nga vitet e kaluara, numri i rasteve të reja ishte 997, ndërsa raste të zgjidhura janë 615. Të dhënat nga viti 2018 janë mbledhur dhe përfshirë në raportin zyrtar të Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve. Për vitin 2019, të dhënat janë mbledhur nga intervistat me përfaqësues nga Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Fëmijëve.

- Direkt nga palët e interesuara të përfshira në konflikt, ose të paktën njëra prej palëve;
- Nga prokurorët dhe gjykatësit për shkak të zbatimit të masave të shmangies në procedurat penale;
- Nga koordinatorë lokalë në bashki, në rastet kur interesat dhe të drejtat e fëmijëve janë shkelur;
- Nga drejtorët e shkollave, mësuesit, psikologët, prindërit, studentët etj.
- Nga oficerët e Zyrave Vendore të Shërbimit të Proves, në rastet kur të miturit janë dënuar apo janë pjesë e përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja për Shmangien.


Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) me Vendimin Nr. 264 datë 21.11.2019 miratoi një metodologji me pikëzime në mënyrë që të përcaktohej niveli i vlerësimit të kryer nga gjykatësit. Përmes kësaj skeme, KLD u kërkon gjyqtarëve të referojnë rastet e ndërmjetësimit (në përputhje me ligjin). Në kontekstin e zbatimit të projektit për forcimin e sistemit të ndërmjetësimit në Shqipëri, KLD ka nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me Qendrën Integrative të Ndërmjetësimit Berlin, në 1 janar 2020. Sipas këtij memorandumi, dy qendra pilot ndërmjetësimi do të hapen në Tiranë dhe Durrës, në të cilat KLD do të ofrojë lehtësimin dhe bashkëpunimin mes qendrave dhe gjykatave. KLD është e hapur për bashkëpunim me MD për të zhvilluar programe për DR dhe ndërmjetësimin.

Siç shihet nga grafiku, përgjatë periudhës 2017-2019, 4821 raste janë zgjidhur përmes ndërmjetësimit. Grafiku për 2019 do të jetë më i lartë se numri total i rasteve të 2018, pasi periudha e raportimit për 2019 përfshin vetëm muajt Janar-Korrik. Raporti i plotë për vitin 2019, me të dhënat për muajt e mbetur, do të publikohet në fund të muajit Prill të 2020. Për periudhën 2018-2019, rastet ku përfshihen interesat e fëmijëve zënë pothuajse 15% dhe për vitin 2019, pritet të jenë më shumë se 20% e numrit total të rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit. Numri i rasteve nga çështje civile apo familjare është gjithashtu i përfshirë në shifra.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka luajtur një rol shumë aktiv në zbatimin e ndërmjetësimit në Shqipëri. Rastet u referohen ndërmjetësve nga burime të ndryshme:

Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konflikteve (FSHZK) është OJQ e parë e themeluar në Shqipëri me nismën e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës së Lartë të Danimarkës, prej projektit të financuar nga Ministria e Jashtme Daneze (DANIDA). Objektivi i krijimit të kësaj OJQ-je është të riaktivizojë ndërmjetësimin në shoqërinë shqiptare dhe të rizgjojë vlerat dhe zakonet tradicionale të

Të dhëna nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve



fushës së pajtimit dhe ndërmjetësimit. FSHZK, me mbështetjen e Këshillit të Europës, përgatitën ligjin e parë të ndërmjetësimit në 1999 me ndihmën e Ministrisë Norvegjeze të Drejtësisë. Ligji i dytë për ndërmjetësimin është përgatitur nga FSHZK në 2003. FSHZK ka mbështetur gjithashtu Parlamentin Shqiptar në hartimin e ligjit ekzistues dhe rishikimeve të tij.

Përgjatë periudhës 2017-2019, FSHZK ka zgjidhur me sukses 296 raste konfliktesh në fushën e krimit në pesë qendra në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Lezhë. Numri i rasteve në fushën e drejtësisë për të mitur ishte 224. Nga këto 224 raste, 106 fëmijë kanë patur statusin e të akuzuarit (10% e kësaj shifre janë 2-3 fëmijë që kanë vepruar në bashkëpunim). 62 fëmijë kanë qenë viktime të sjelljeve të këqija ose kriminale nga një fëmijë tjetër apo i rritur dhe ka patur 56 të rritur të cilët ose kanë qenë viktime të sjelljes së fëmijëve, ose të akuzuar për fëmijët viktime.

Grafiku i mëposhtëm mbledh të dhëna nga vitet përpara miratimit të Kodit për Drejtësinë për të Mitur. Krahas 9 rasteve që janë referuar në qendrat e ndërmjetësimit nga shkollat, pjesa tjetër përfaqësohet nga Shërbimi i Provës, Policia e Shtetit dhe së fundmi nga Zyra e Prokurorisë.

Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare të Forumit Europian për Drejtësinë Restauruese në Shqipëri, për të 10-tën herë, përfaqësoi një moment kyç përsa i përket Drejtësisë Restauruese dhe ndërmjetësimit. Kjo ishte një thirrje për veprim për institucionet publike shqiptare, sidomos për sistemin e drejtësisë, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, sistemin juridik, prokuroritë, sistemin e burgjeve, si dhe Shërbimin e Provës për të ndërmarrë nisma në fushën e ndërgjegjësimit, promovimit dhe zbatimit të DR dhe ndërmjetësimit, sidomos në rastet që përfshijnë të miturit dhe të rinjtë në kontakt dhe konflikt me ligjin. Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, si Delegacioni i BE në Tiranë, UNICEF, Save the Children, Terre des hommes etj., kanë ofruar mbështetje dhe fonde për projekte konkrete dhe nisma në fushën e DR dhe ndërmjetësimit. Inspirimi i post-konferencës ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e FSHZK

si një organizatë që promovon DR në Shqipëri. Ajo shërbeu gjithashtu për të ndërmarrë dhe mbështetur disa nisma, mes të cilave vlen të përmenden:

Ministria e Drejtësisë ka luajtur një rol kyç në vënien në zbatim të reformës në drejtësi, duke sjellë kështu rritje të ndërgjegjësimit institucional në përdorimin e praktikave restauruese dhe ndërmjetësimin. Ministria kërkoi që të zhvillohen programe që forcojnë alternativat e ndërmjetësimit në Shqipëri. 25 ndërmjetës janë të kualifikuar për të ofruar shërbime ndërmjetësimi për të miturit si pjesë e dy programeve, i pari i mbështetur nga Delegacioni i BE dhe i vënë në zbatim nga FSHZK, Terre des hommes, dhe Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe programi i dytë i mbështetur gjithashtu nga Delegacioni i BE dhe i vënë në zbatim nga Qendra për Ndërmjetësim Integrativ Berlin, FSHZK dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve. FSHZK ka ndërtuar një hartë të sistemit të drejtësisë kriminale përmes perspektivës së Drejtësisë Restauruese. Një panoramë e situatës në lidhje me nevojat dhe mundësitë është identifikuar nga kjo hartë, së bashku me rekomandimet për politikëbërësit dhe praktikuesit e DR. FSHZK ka organizuar gjithashtu një sërë trajnimesh.^[53] Në 2018-2019, 160 raste të të miturve janë menaxhuar nga FSHZK përmes drejtësisë restauruese dhe veprimeve ndërmjetësuese.

4.2.2 Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)

Neni 38 gërma "h" e Ligjit Nr. 37/2016 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" përcakton se: "Prokuroria e Përgjithshme dërgon të dhënat statistikore mbi çështjet penale tek MD në mënyrë që të hartohen statistikat e përbashkëta në fushën e drejtësisë." Sidoqoftë, KLP nuk ka të dhëna mbi aplikimin e programeve të DR dhe ndërmjetësimit. Të dhënat statistikore të marra nga zyra e Prokurorisë së Përgjithshme tregojnë se në 2019, zyrat e Prokurorëve të Rretheve kanë vendosur mbylljen e 19 rasteve dhe aplikimin e masave ndërmjetësuese për to.

Disa nga rastet penale ku ndërmjetësimi është

^[53] UNICEF ka mbështetur trajnime në DR për 75 oficerë të shërbimit të provës dhe hartimin e instrumentit për monitorimin e implementimit të KDM në raport me aplikimin e masave rehabilituese në programet e DR dhe përgatitjen e një manuali për praktikuesit e DR. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka kërkuar FSHZK të kryejë trajnime për stafin e burgjeve mbi qasjet e DR. Terre des hommes, në bashkëpunim me FSHZK, janë duke zbatuar projektin e qasjeve restauruese për të miturit. Organizatat e shoqërisë civile që morën pjesë në konferencë kanë shprehur interes të lartë për të aplikuar në skemën e granteve të projektit. Temat kryesore për ndërhyrje që po mbështeten nga skema sub-grantuese fokusohen në DR dhe ndërmjetësimin për të miturit.



përdorur janë: rastet e sulmeve fizike, vjedhjeve banale, shantazhe etj. Në një nga rastet, një studente e vitit të parë të fakultetit shantazhoi profesorin e saj në mënyrë që të merrte nota më të larta. Pas fillimit të procedurave penale, prokurori propozoi një procedurë ndërmjetësimi në mënyrë që të ndalohej procedimi penal. Studentja i ka kërkuar falje profesorit të saj dhe rasti është zgjidhur me sukses përmes ndërmjetësimit.

Në një rast tjetër, një djalë i ri është kapur nga një punëtor supermarketi duke vjedhur dy filxhanë kafeje. Ashtu si në rastin e parë, pas fillimit të procedurave penale është vijuar me propozimin e ndërmjetësimi çka mbylli procedurën penale. I riu është takuar me punëtorin e supermarketit në një sesion ndërmjetësimi dhe kanë rënë dakord për rimbursimin e dëmit. Ai ka premtuar gjithashtu se nuk do e bëjë më atë veprim. Prindërit ishin gjithashtu të përfshirë në proces.

4.3 Të dhënat e analizuara nga pyetësorët

Ky projekt-studim ofroi modelet për pyetësorët, të cilave iu përgjigjën gjyqtarë, prokurorë, koordinatore lokakë të mbrojtjes së fëmijëve, përfaqësues nga Shërbimi i Provës, punonjës të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës e kështu me rradhë. Çdo pyetje është trajtuar në një rubrikë të veçantë dhe në një grafik ose tabelë për përgjigjet e mbledhura dhe analizuara. Struktura është si vijon:

1. Njohja e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit. Fokus grupet gjatë të cilëve u dhanë dhe u plotësuan pyetësorët tregojnë se pothuajse të gjithë pjesëmarrësit kanë një njohje të mirë të drejtësisë restauruese


dhe ndërmjetësimit. Vetëm 7 prej 113 pjesëmarrësve nuk kanë njohuri mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Midis atyre që ishin të familjarizuar me këto terma, njohja vjen për shkak të sesioneve të trajnimeve dhe nga zbatimi i legjislacionit me të cilin ata punojnë. Vetëm 5 pjesëmarrës ishin të informuar rreth ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese nga media. Grafiku më sipër tregon ndërgjegjësimin dhe njohjen e drejtësisë restauruese ku disa pjesëmarrës zgjedhën më shumë se një burim informacioni, psh. trajnimi dhe legjislacioni.

2. Eksperienca me rastet e drejtësisë për të mitur.


Një nga pyetjet e pyetësorit i drejtohet pjesëmarrësve lidhur me eksperiencën e tyre në çështjet e drejtësisë për të mitur. Pavarësisht faktit se gjyqtarët dhe prokurorët ishin përfaqësues të seksioneve të krijuara pas miratimit të KDM, disa prej tyre (dhjetë nga secili profesion) nuk kishin eksperiencë me çështjet e drejtësisë për të mitur. Pjesa tjetër (17 gjyqtarë dhe 12 prokurorë) kishin eksperiencë me këto lloj rastesh.

Disa arsye lidhen me këtë mospërputhje. Së pari, sektorët e gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet e të miturve trajtojnë gjithashtu rastet e dhunës në familjes, së dyti, seksionet e sistemit të Gjykatës ndryshojnë çdo vit çfarë do të thotë se gjyqtarët transferohen nga një seksion në tjetrin, dhe së treti, ka patur një reformë të thellë ligjore në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Si rezultat, shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar. Kjo ka çuar gjithashtu në ndryshime rrënjësore tek stafi. Në tërësi, numri i pjesëmarrësve në fokus grupe që kishin eksperiencë në çështjet e drejtësisë për të mitur shkoi në 77. Numri i pjesëmarrësve që nuk kishin eksperiencë në këtë fushë ishte 36.

Njohja e drejtësisë restauruese




Eksperienca me rastet e drejtësisë për të mitur
